

KOMUNITETI I TË NXËNIT DEMOKRATIK DHE GJITHËPËRFSHIRËS

Informata dhe materiale mësimore
për mësimdhënësit dhe drejtorët



Libër burimor për trajnerë

Funded
by the European Union
and the Council of Europe



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Implemented
by the Council of Europe

KOMUNITETI I TË NXËNIT DEMOKRATIK DHE GJITHËPËRFSHIRËS

Informata dhe materiale mësimore për
mësimdhënësit dhe drejtorët

Riprodhimi i pjesëve (deri në 500 fjalë) është i autorizuar, përveç për qëllime komerciale, për derisa rruhet origjinaliteti i tekstit, pjesët nuk përdoren jashtë kontekstit, nuk ofron informacion të pakompletuar apo nuk e keqinformon lexuesin në ndonjë mënyrë tjetër sa i përket natyrës, fushëveprimit apo përmbajtjes së tekstit. Burimi i tekstit duhet gjithmonë të përmendet, si në vijim “© Këshilli i Evropës, viti i publikimit”. Të gjitha kërkesat e tjera përkitazi me riprodhimin/përkthimin e të gjitha ose disa pjesëve të dokumentit duhet të drejtohen tek drejtorja e komunikimeve, Këshilli i Evropës (F-67075 Strasbourg Cedex or publishing@coe.int).

Dizajni dhe faqosja: Departamenti i prodhimit të dokumenteve dhe publikimeve (DPDP), Këshilli i Evropës

Burimi i fotografive: Shutterstock dhe projekti INCLUDE

Ky publikim nuk është edituar nga Njësia editoriale e DPDP për të korrigjuar gabimet e shtypit apo ato gramatikore.

© Këshilli i Evropës, Gusht 2021. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Licensuar nga kushtet e Bashkimit Evropian.

Shtypur nga Këshilli i Evropës

Përgatitur nga Rolf Gollob

Ky dokument është përgatitur në kuadër të projektit “INCLUDE – Ndërtimi i kapacitetit për Arsim Gjithëpërfshirës” me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës. Opinionet e shprehura këtu nuk mund të asnjë mënyrë të merren si pasqyrim i opinionit të asnjëres palë.

Përmbajtja

HYRJE	5
PJESA A: GJITHËPËRFSHIRJA DHE DIVERSITETI. NJOHURI DHE ZBATIM I PËRGJITHSHËM	7
ÇFARË ËSHTË MIRË TË DIHET	9
Shkolla e ndjeshme ndaj diversitetit: Tri dimensione	9
Diversiteti dhe diferenca në shkollë	10
Integrimi dhe gjithëpërfshirja	10
Misioni social dhe arsimor i shkollave	11
Fushat e tensionit në shkolla	11
Diversiteti, diferenca dhe gjithëpërfshirja arsimore - pretendimi i gjithëpërfshirjes	13
ÇFARË ËSHTË MIRË TË REFLEKTOHET	15
Nevoja për t'u përballur me vetveten	15
Qëndrimi, imazhi njerëzor dhe të kuptuarit e profesionit	15
Niveli i marrëdhënies pedagogjike	16
Pesë parime për mësimdhënien e ndjeshme ndaj diversitetit në shkollat normale gjithëpërfshirëse	17
Pranimi i diversitetit - mundësimi i pjesëmarrjes - formësimi i identitetit (praktikë)	17
SI TË PLANIFIKONI MIRË: GJASHTË HAPA DREJT PLANIFIKIMIT TË MËSIMEVE GJITHËPËRFSHIRËSE	19
Hyrje	19
Hapi 1: Pranoni realitetin e heterogjenitetit	19
Hapi 2: Diagnostifikimi në klasë	20
Hapi 3: Dokumentimi i zhvillimit të mësimnxënies	20
Hapi 4: Caktimi i qëllimeve së bashku	20
Hapi 5: Reflektoni mbi proceset e mësimnxënies	20
Hapi 6: Dokumentimi i rezultateve përfundimtare të mësimnxënies	22
PJESA B: KRKKD NGA KËSHILLI I EVROPËS	24
INFORMATA TË PËRGJITHSHME:	25
Këshilli i Evropës: një histori e shkurtër e një institucioni të rëndësishëm	25
Kompetencat për kulturë të demokracisë:	26
Si të përdorni Modelin e Kompetencës	35
PJESA C: NJË FORMË E RËNDË E PËRJASHTIMIT TË PËRDITSHËM: BULLIZMI	39
HYRJE: BULLIZMI - NJË TEMË E RËNDËSISHME KUDO	40
Dhe çfarë kur mësimdhënësi është bullist?	40
Informata të përgjithshme për temën e bullizmit për edukatorët	41
Ndërmarrja e veprimeve në temën e bullizmit	48
PJESA D: AKTIVITETE ARSIMORE	56
USHTRIME DHE PLANE MËSIMORE PËR PËRDORIM TË PËRDITSHËM	57
Ndërtimi i atmosferës në klasë	57
Qartësimi i vlerave	62
Njohja me të drejtat e njeriut	64
Perceptimi i të tjerëve	68
PËRFSHIRJA NË PUNËN E PROJEKTIT - SHEMBUJ TË PROJEKTEVE MJEDISORE	72
Hyrje: edukimi mjedisor me histori të gjatë	72
Kopsht shkollë: Gëzim dhe punë për të gjithë	72
Mësimnxënja e bazuar në shërbim për një mjedis të pastër: Dita e pastrimit.	74
PJESA E: LITERATURA:	79

HYRJE

Brazia, drejtësia dhe pjesëmarrja janë parimet thelbësore të gjithëpërfshirjes. Ky supozim themelor është i rëndësishëm, pasi që në diskutimin profesional të viteve të fundit, termi “gjithëpërfshirje” përdoret shumë shpesh dhe në mënyra shumë të ndryshme. Në literaturë, termat integrim dhe gjithëpërfshirje nuk janë të mbushura njëtrajtësisht me përmbajtje. Për të realizuar një gjithëpërfshirje të suksesshme, nuk mjafton thjesht integrimi i një nxënësi me nevoja të veçanta arsimore në klasën e rregullt. Ky manual me titullin ‘Komuniteti i të nxënësve demokratik dhe gjithëpërfshirës’ bazohet, pra, në të kuptuarit e gjithëpërfshirjes, që është paraparë në Konventën për të Drejtat e Njeriut. Me këtë qasje, të gjithë njerëzit respektohen, pavarësisht nga gjinia e tyre, statusi socio-ekonomik, aftësia e kufizuar, prejardhja migrante, etj. Në shkollë, të gjithë nxënësit duhet të kenë të njëjtat të drejta dhe qasje në shkollën e rregullta dhe të marrin mbështetje shtesë të të nxënësve për të shmangur përjashtimin. Siç kanë treguar raportet¹, Romët, Ashkalinjtë dhe Egjiptianët që jetojnë në Kosovë në thelb kontribuojnë në shoqërinë e vet të larmishme me traditat dhe kulturat e tyre të veçanta. Sidoqoftë, shumica e njerëzve të tri komuniteteve shpesh jetojnë në margjinat e shoqërisë, duke luftuar me nivele të larta të papunësisë dhe nivele të ulëta arsimore. Për më tepër, anëtarët e komunitetit Rom, Ashkali dhe Egjiptian përballen me pengesa që çojnë në përjashtimin e tyre nga pjesëmarrja në të gjitha fushat e jetës. Këtu, shkolla gjithashtu përmbush misionin e vet për të krijuar një komunitet në të cilin të gjithë nxënësit, pavarësisht nga të nxënësve individual dhe parakushtet e sjelljes, trajtohen me të njëjtin pranim dhe vlerësim si shenjë e Kulturës së Demokracisë në veprim të nënvizuar përmes (20) kompetencave përkatëse të zbatuar dhe të dukshme të Kornizës Referencë për Kompetencat për Kulturë Demokratike (KRKKD) nga Këshilli i Evropës. Një koncept i fortë i gjithëpërfshirjes është në të njëjtën kohë një shenjë e rëndësishme për një demokraci në veprim në jetën e përditshme të të gjithë njerëzve. Kjo është arsyeja se pse kornizës së referencës i jepet ca hapësirë në këtë manual. Gjithëpërfshirja dhe demokracia nuk duhet të mbeten teori. Në punën e përbashkët, në projektet e përbashkëta, për shembull, duke u përfshirë në mënyrë aktive në mjedis, bëhet e qartë nëse diferencat në aftësi ose mënyra të të menduarit përdoren vërtet për të gjetur zgjidhje të mira. Për fat të keq, gjithëpërfshirja gjithmonë përfshinë të kundërtën: përjashtimin. Një nga përvojat e tmerrshme ditore të shumë nxënësve është bullizmi. Si shfaqet ai? Kush e bën atë? Kush vuan nga ai dhe mbi të gjitha: çfarë mund të bëhet në mënyrë parandaluese ose aktive kundër tij? Ky manual synon gjithashtu të sigurojë hapësirë për këtë duke sugjeruar mënyra të qarta për ta njohur atë, por edhe udhëzime për veprim.

Ky manual nuk është një libër teorik, por sugjerimet dhe këshillat bazohen në njohuri dhe përvojë. Prandaj, ne u urojmë të gjithë përdoruesve çdo sukses në udhëtimin drejt një arsimit cilësor për të gjithë, siç kërkohet nga Agjenda e OKB-së 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm. Qëllimi 4 kërkon që të gjitha vendet anëtare të “sigurojnë arsim gjithëpërfshirës, të barabartë dhe cilësor dhe të promovojnë mundësi për të mësuar gjatë gjithë jetës”. Gjithçka e propozuar në këtë manual shkon pikërisht në këtë drejtim.

¹ https://www.osce.org/files/f/documents/6/7/443587_1.pdf

PJESA A:
GJITHËPËRFSHIRJA DHE
DIVERSITETI. NJOHURI
DHE ZBATIM I PËRGJITHSHËM



Diversiteti njerëzor në të gjitha aspektet e tij është burim dhe sfidë për shoqërinë. Zhvillimi i potencialeve të ndërlidhura kërkon njohuri dhe strategji të përshtatshme.

Zhvillimi bashkëkohor i shkollave dhe mësimdhënies kërkon vullnetin për ta nënshtruar vendndodhjen e shkollës në një proces që analizon qëndrimet dhe procedurat në trajtimin e diferencës dhe diversitetit. Bazuar në këtë, duhet të ndërmerren hapa konstruktivë për të hartuar dhe instaluar një deklaratë të misionit shkollor të ndjeshëm ndaj diversitetit.

Qëllimi duhet të jetë perceptimi dhe fuqizimi i fëmijëve dhe të rinjve si individë me të gjitha nevojat dhe mundësitë e tyre dhe në këtë mënyrë t'i fuqizojë ata për jetë në një shoqëri demokratike që ndryshon vazhdimisht, e karakterizuar nga diversiteti.

Të paktën katër kushte duhet të plotësohen në mënyrë që të flitet për gjithëpërfshirje të suksesshme (UNESCO, 2005²):

- ▶ **PREZENCA:** Të gjithë fëmijët duhet të kenë mundësinë të ndjekin mësim në klasa së bashku me shokët/shoqet e tyre të klasës në një klasë normale.
- ▶ **PRANIMI:** Të gjithë fëmijët, me karakteristikat e tyre të ndryshme, individuale, duhet të jenë pjesë e komunitetit.
- ▶ **PJESËMARRJA:** Të gjithë fëmijët duhet të marrin pjesë në aktivitete dhe mësim të përbashkëta.
- ▶ **ARRITJA:** Të gjithë fëmijët duhet të jenë në gjendje të arrijnë qëllime sfiduese të mësimnxënies, të performojnë mirë dhe të përparojnë dhe të arrijnë brenda aftësive të tyre individuale.

Shkolla ka një mision arsimor që nuk mund të kënaqet thjesht me pranimin e të gjithëve ashtu siç janë për momentin dhe gëzimin për këtë diversitet shumëngjyrësh. Diversiteti, mënyra se si kuptohet këtu duhet të jetë më shumë se konfirmim pohues se 'gjithçka është kaq e bukur me shumë ngjyra'. Mandati pedagogjik në shkolla nuk është të pranojë forma të caktuara të diferencës (më saktësisht: dimensionet e diversitetit), por t'i vendosë në një vijë. Për shembull, nuk duhet thjesht të pranojë që disa mund të lexojnë dhe të tjerët nuk mundën por të sigurojë që të gjithë nxënësit të mësojnë të lexojnë sa më mirë që të jetë e mundur. Situata të ndryshme gjithashtu kërkojnë ndërhyrje të ndryshme për të njëjtin individ. Një shkollë gjithëpërfshirëse është një shkollë që merr parasysh parakushtet e ndryshme individuale të mësimnxënies dhe sjelljes të nxënësve të saj sa më saktë që të jetë e mundur, dhe i merr ato parasysh me masat e duhura, specifike në situatat konkrete të mësimdhënies.


2 http://www.ibe.unesco.org/sites/default/files/Guidelines_for_Inclusion_UNESCO_2006.pdf

ÇFARË ËSHTË MIRË TË DIHET

SHKOLLA E NDJESHME NDAJ DIVERSITETIT: TRI DIMENSIONE

Diskutimi i gjithëpërfshirjes shkollore përfshinë të gjitha fushat e arsimit shkollor. Për të ruajtur qartësinë dhe për të gjetur nivelet e ndryshme, është e rëndësishme të orientoheni drejt tri dimensioneve. Secila prej tri dimensioneve përbën fokus zhvillimi. Ka mbivendosje për sa i përket përmbajtjes, pasi fushat e ndryshme nuk mund të përvijohen gjithmonë qartë nga njëra-tjetra.

- | | |
|---|--|
| a) Burimet njerëzore: | Krijimi i kulturave gjithëpërfshirëse |
| b) Përmirësimi i mësimdhënies dhe mësimnxënies: | Zhvillimi i praktikave gjithëpërfshirëse |
| c) Zhvillimi i organizimit: | Krijimi i strukturave gjithëpërfshirëse |



Trekëndëshi ilustron se si tri dimensionet dhe tre faktorët kryesorë janë të ndërlidhur.

Burimet njerëzore: Krijimi i një kulture gjithëpërfshirëse

Ky dimension ka të bëjë me ndërtimin e një komuniteti të sigurt dhe mirënjohës, bashkëpunues dhe stimulues, mikpritës dhe vlerësues për të gjithë. Vlerat e përbashkëta gjithëpërfshirëse zhvillohen dhe bëhen të qasshme për të gjithë personelin e shkollës, fëmijët dhe të rinjtë, prindërit dhe kujdestarët, anëtarët e komiteteve të shkollës, iniciativat dhe grupet në komunitetin përreth, si dhe të gjithë ata që punojnë në shkollë dhe me të. Vlerat e kulturave shkollore gjithëpërfshirëse ofrojnë udhëzime në vendimet për strukturat dhe praktikave të përditshme në mënyrë që shkolla të zhvillohet në një proces të vazhdueshëm holistik.

Përmirësimi i mësimdhënies dhe mësimnxënies: Zhvillimi i praktikave gjithëpërfshirëse

Ky dimension ka të bëjë me zhvillimin e proceseve të mësimnxënies që pasqyrojnë vlerat dhe strukturat gjithëpërfshirëse të shkollës. Ky dimension lidh mësimnxënien me përvojat vendore dhe globale të fëmijëve, të rinjve dhe të rriturve dhe përfshin çështje të të drejtave dhe qëndrueshmërisë. Nxënësit inkurajohen të jenë nxënës aktivë dhe kritikë. Ata vetë shihen si burim për të mësuar së bashku. Të rriturit punojnë së bashku dhe marrin përgjegjësi për mësimin e përbashkët dhe mësimin e të gjithë fëmijëve dhe të rinjve.

Zhvillimi i organizimit: Krijimi i strukturave gjithëpërfshirëse

Ky dimension siguron që gjithëpërfshirja si parim udhëzues përshkon të gjitha nivelet e një shkolle dhe përfshinë të gjithë. Fëmijët, të rinjtë dhe personeli i shkollës inkurajohen që të marrin pjesë aktivisht që nga fillimi. Shkolla inkurajohet të mirëpresë të gjithë fëmijët dhe të rinjtë në zonën përreth saj dhe të minimizojë presionin për t'u veçuar. Kjo ndihmohet nga të gjitha aktivitetet që i japin mundësi shkollës t'i përgjigjet diversitetit të fëmijëve, të rinjve dhe të rriturve dhe t'i vlerësojë të gjithë.

DIVERSITETI DHE DIFERENCA NË SHKOLLË

Sa i përket zhvillimeve komplekse shoqërore dhe diferencimit progresiv shoqëruar të realitetit shoqëror, trajtimi i diversitetit njerëzor në të gjitha dimensionet e tij në shkolla merr një domethënie të re.

Shkollat kanë një përgjegjësi shumë të veçantë në këtë ndryshim në shoqëri. Çdo ditë, fëmijë dhe të rinj dhe të rritur me prejardhje, qëndrime dhe personalitete nga më të larmishmet, bashkohen në to. Ata bashkëveprojnë me njëri-tjetrin në një mënyrë intensive dhe formuese dhe mësojnë me dhe nga njëri-tjetri.

Në mënyrë që të trajtohet në mënyrë efikase kjo gjendje fillestare dhe mundësitë që rezultojnë, një kuptim gjithëpërfshirës i një qasjeje të qëndrueshme ndaj diversitetit dhe diferencës në të gjitha nivelet e shkollës është thelbësore. Proceset bashkëkohore të zhvillimit të shkollës nuk mund të mendohen më pa përfshirë këto fakte.

Një shkollë me kompetencë ndaj diversitetit kërkon koncepte të arsimit që, përveç të mësimnxënies të drejtë dhe jo-diskriminues, mundësitë e zhvillimit dhe evolucionit për të gjithë nxënësit, gjithashtu përqendrohen në mësimdhënien që gjithmonë përpiqet të edukojë për bashkëjetesë theksuese, të respektueshme dhe tolerante në hapësirën shoqërore. Njohja e pikave të forta individuale, aftësive dhe përparimit është thelbësore për këtë.

Paketa e autonomisë u ofron shkollave mundësinë për të zhvilluar lirinë e re pedagogjike, organizative dhe të personelit në vendet e tyre dhe për të kombinuar qasje të ndryshme pedagogjike në një mënyrë kuptimplote. Një qasje e qëllimshme ndaj diversitetit dhe ndryshimit në shkolla ka nevojë saktësisht për atë: mundësinë për të lejuar qasjet dialektike dhe, bazuar në këtë, për të zhvilluar zgjidhje të përshtatshme për vendin përkatës të shkollës.

Qëllimi i kësaj fushe tematike është të paraqesë impulse dhe qasje bashkëkohore për një teori dhe praktikë pedagogjike të vetëdijshme për diversitetin te njerëzit që punojnë në shkolla. Do të doja që t'i ftoja ata të interpretojnë dhe peshojnë përsëri prioritetet e detyrave kryesore të shkollës në vendin e tyre.

Ky punim është shkruar në besimin se shkollat mund të formojnë ndryshimin shoqëror dhe të jenë agjentë të ndryshimit, përkundër sfidave, duke marrë një pozicion të qartë dhe duke marrë pjesë në mënyrë aktive në formësimin e ndryshimeve pozitive shoqërore.

INTEGRIMI DHE GJITHËPËRFSHIRJA

Ndërsa pluraliteti i pashmangshëm i shoqërisë diskutohet më së shumti në diskursin për heterogjenitetin, debati mbi diversitetin i përket diskursit për gjithëpërfshirjen.

- ▶ Gjithëpërfshirja e njeh diversitetin në të gjitha format e saj si vlerë, e sheh atë si një mundësi dhe jo si një barrë apo problem.
- ▶ Integrimi në kuptimin e drejtpërdrejtë do të thotë rivendosja e një tërësie nga pjesët e saj. Kjo nënkupton idenë se ekziston një shumicë normale në të cilën do të (ri)integrohet një pakicë kundërshtuese.

Përkundër kësaj prapavije, gjithëpërfshirja mund të kuptohet si integrimi i vazhdueshëm i individëve dhe grupeve përkatësia e të cilëve në normë ose në kulturën mbizotëruese të shumicës nuk është ose nuk ishte dhënë, siç është padyshim rasti për komunitetin Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë. Parakushti themelor është kështu aftësia për të "zhvendosur kufijtë" e konceptimeve tona për normat.

Integrimi	Gjithëpërfshirja
Integrimi i fëmijëve me nevoja specifike ose me një përkatësi etnike specifike në shkollat normale	Bashkëjetesa dhe mësimnxënia së bashku për të gjithë fëmijët në shkollat normale
Teoria me dy grupe	Teoria e një grupi ekuivalent
Qasja me individin në qendër	Qasja sistemike
Burime për fëmijë me etiketim	Burime për sisteme
Mbështetje e veçantë p.sh. Për fëmijë me vështirësi në të folur dhe aftësi të kufizuara	Mësimnxënia e përbashkët dhe individuale për të gjithë
Mësimdhënësit me nevoja të veçanta si mbështetje për fëmijët me nevoja të veçanta ose të veçanta arsimore	Mësimdhënësit me nevoja të veçanta si mbështetje për mësimdhënësit e klasave, klasat, shkollat
Kontrolli nga ekspertët	Zgjidhja kolegjiale e problemeve në një ekip

MISIONI SOCIAL DHE ARSIMOR I SHKOLLAVE

Ligji themelor, të drejtat e njeriut dhe të drejtat e fëmijëve, si dhe detyrimi për të njohur Konventën e OKB-së për të Drejtat e Njeriut janë vetëm disa shembuj të teksteve ligjore që formojnë një bazë ligjore për parandalimin e diskriminimit, disavantazhit dhe përjashtimit të individëve ose grupeve në shoqërinë tonë .

Në kurrikulën e shkollave të arsimit të përgjithshëm thuhet qartë se shkollat kanë një mandat arsimor për të parandaluar struktura të pafavorshme, për të siguruar mundësi të barabarta në shoqëri dhe për të edukuar për vetëvendosje, bashkë-përcaktim dhe solidaritet.

“Respekti dhe njohja reciproke janë qëllime të rëndësishme arsimore, veçanërisht në kontekstin e marrëdhënieve të shoqërisë me diversitetin, diferencën dhe identitetin. Përceptimi i mundësive demokratike për të thënë dhe për të marrë pjesë në fusha të ndryshme të jetës dhe shoqërisë kërkon aftësinë për të formuar gjykime faktike dhe të lidhura me vlerën dhe për të marrë përgjegjësi shoqërore. Për të zhvilluar këto aftësi, vetë-efikasiteti, si dhe mësimdhënia e vetë-përcaktuar dhe e vetë-organizuar dhe veprimi i pavarur duhet të promovohen në një shkallë të lartë.

Do të shkonte përtej fushëveprimit të kësaj fushe tematike për të parë konceptin e arsimit në detaje. Ekziston një hendek shumë i gjerë midis të kuptuarit të arsimit që reduktohet në një “trajnim” thjesht formal të të rinjve që synon “krijimin” e kapitalit njerëzor të dobishëm ekonomikisht dhe idealit Humboldtian të arsimit, i cili synon të arsimojë individin të bëhet një qytetar i ndriçuar i botës.

Një staf mësimdhënësish duhet të jetë i përgatitur të përballet dhe drejtojë këtë diskutim. Një konsensus i përpunuar që çdo mësimdhënës mund të pranojë të formojë bazën konceptuale të një kulture shkollore, ndër të tjera.

Një shkollë që ndihet e detyruar të përmbushë misionin e saj si të tërë dhe të veprojë në kuptimin e ruajtjes së një rendi shoqëror demokratik të lirë, duhet të përpiqet për një koncept të arsimit që, përveç kualifikimit të përmbajtjes, dëshiron të ndihmojë në formimin e maturitetit pjesëmarrës të personalitetit dhe kompetencës shoqërore të nxënësve të saj.

Një shqetësim dhe synim kryesor duhet të jetë, pra, të perceptojnë dhe fuqizojnë fëmijët dhe të rinjtë si individë me të gjitha nevojat e tyre dhe në të njëjtën kohë t’i fuqizojnë ata për jetën në një shoqëri demokratike që ndryshon vazhdimisht e karakterizuar nga diversitetit.

Kjo kërkon një kuptim holistik të arsimit që i mundëson individit të njohë dhe zhvillojë potencialin e tij ose të saj në të gjitha nivelet, si dhe atë të të tjerëve. Ndjeshmëria dhe aftësia për të marrë perspektivë mundësojnë të kuptuarit e faktit se të gjithë njerëzit, përkundër të gjitha diferencave, përpiqen për të njëjtat gjëra në thelbin e genies së tyre.

FUSHAT E TENSIONIT NË SHKOLLA

Pritshmëritë e larta u vihen mësimdhënësve nga politika, biznesi, kërkimi dhe prindërit. Përveç dhënies së njohurive, nga ta pritët të kontribuojnë në zgjidhjen e problemeve komplekse sociale.

Një mandat arsimor i rritur për shkak të një trupi të ndryshuar nxënësish, përballja me kurrikula të mbingarkuara me përmbajtje dhe ballafaqimi me një realitet të ndryshuar në shoqëri në tërësi në lidhje me ndërveprimin ndërpersonal paraqesin shkolla me sfida të qarta dhe kërkojnë qasje të reja didaktiko-metodologjike në lidhje me trajnimin e diversitetit dhe diferencës.

Në mënyrë që një shkollë të mbetet e aftë të veprojë në këtë situatë, i duhen qëndrime, koncepte, struktura bashkëkohore pedagogjike dhe një gatishmëri e rritur për ndryshim dhe angazhim.

Duke pasur parasysh sfidat e përshkuara, është njerëzisht e kuptueshme që ekziston një “dëshirë e madhe” për kushte të qarta kornizë dhe se vizatohet një imazh lavdërues i “mësimdhënies së duhur” dhe “shkollës së mirë” që ndodhet në një të kaluar të lavdishme.

Përprerja e një politike arsimore për të mbështetur shkollat përmes “parametrave të qartë” është e mbushur me rrezik. Synimi i zgjidhjeve strukturore gjoja të thjeshta por vetëm afatshkurtra është e barabartë me trajtimin e simptomave, të cilat në planin afatgjatë akoma japin shkaqet e rritjes së shumë prej problemeve të shkollës. Studime të shumta shkencore vërtetojnë se një sistem arsimor i bazuar në ndarje prodhon humbës arsimorë në planin afatgjatë dhe parandalon proceset e zhvillimit të qëndrueshëm të institucioneve arsimore.

Diversiteti është vetëm një çështje për shkollat në zonat urbane?

Në zonat rurale dhe urbane, vendet e shkollave ndryshojnë në lidhje me shprehjen dhe shfaqjen e kategorive të diversitetit. Kjo mund të krijojë përshtypjen se nevoja për të adresuar këtë çështje nuk është e pranishme në shkollat rurale. Të kuptuarit bashkëkohor të ndryshimit dhe diversitetit duhet të lidhet me të gjitha nivelet e ekzistencës njerëzore.

Në qasjen e “diferencimit fleksibël” (shih fushën tematike “Diferencimi”) bëhet e qartë se edhe në grupe të supozuara homogjene të mësimnxënies, nxënësit ndryshojnë ndjeshëm nga njëri-tjetri për sa i përket aftësive, shkathtësive, njohurive paraprake, interesave, gatishmërisë dhe profileve të mësimnxënies. Prandaj, mësimdhënia e diferencuar duhet ta marrë parasysh këtë nëse do të ofrojë mundësi të përshtatshme për të gjithë nxënësit.

Nëse zbatohet në mënyrë të përshtatshme, kompetencat shoqërore dhe puna e pavarur dhe autonome e lidhur me përmbajtjen e nxënësve rriten dhe cilësia e “prodhimit” rritet. Në planin afatgjatë, kjo i lehtëson mësimdhënësit në punën e tyre të përditshme, sepse stresi i perceptuar mund të zvogëlohet nga të gjithë pjesëmarrësit që përjetojnë vetë-efikasitet dhe një ndjenjë e kënaqësisë mund të rritet.

Sjellja e ndryshimeve të prekshme në shkolla kërkon përkushtim, vizion dhe durim. Largimi nga një mendësi e përzgjedhjes që kategorizon, klasifikon dhe refuzon të rinjtë drejt një qëndrimi pozitiv dhe proaktiv dhe njohja e diversitetit si normalitet merr një gjë mbi të gjitha: kohën. Strukturat dhe gjurmët e thella që janë krijuar me dekada nuk janë të lehta për t’u ndryshuar. Gjithëpërfshirja është pra “një proces i pafund”, nëse doni, një “operacion i zemrës së hapur” i përhershëm i një shkolle.

Një proces i zhvillimit të shkollës i ndjeshëm ndaj diversitetit ka nevojë për përkatësinë:

- ▶ Zhvillimi i burimeve njerëzore
- ▶ Zhvillimi i mësimave
- ▶ Zhvillimi organizativ

Në rrjedhën e mëtejshme të fushës tematike, të tri pikat shikohen më nga afër.

Shkolla si vend riprodhues i pabarazisë sociale

Një përqindje shumë e lartë e mësimdhënësve ende vijnë nga prejardhje stabile të klasës së mesme. Ata përgjithësisht kanë pasur përvoja të tyre pozitive në shkollë për sa i përket pjesëmarrjes dhe performancës në shkollë.

Shumë fusha të shkollës dhe mësimdhënies janë ende të bazuara në idenë e një “norme mesatare” të nxënësve. Proceset planifikohen dhe zbatohen mbi këtë bazë. Kjo mbart rrezikun që shkollat të jenë të orientuara drejt “mediokritetit” dhe që shumë potenciale dhe nevoja të nxënësve të anashkalohen. Pasojat mund të përfshijnë përvojën subjektive të përjashtimit dhe diskriminimit, si dhe shfaqjen e strukturave të pafavorshme dhe pengesave për të mësuar.

Mësimdhënësit duhet të jenë të vetëdijshëm se si veprimet e tyre të përditshme mund të krijojnë ndryshim dhe disavantazh. Vetëm duke u bërë i vetëdijshëm për dinamikë të tillë, hapësira për ndryshim mund të krijohet dhe kundërveprohet në planin afatgjatë. Shkathtësitë e vetë-reflektimit, vetë-kritikës dhe marrjes së perspektivës janë parakushte për këtë.

Një shkollë që përcakton barazinë dhe mundësitë e barabarta si pjesë e parametrave të synuar të kulturës së saj shkollore do të gjenerojë një marrëdhënie pozitive dhe klimë pune nga e cila përfitojnë të gjithë personat. Kështu një mori problemesh tipike shkollore dhe shkaqe të konfliktit mund të zbuten, kundërveprohen ose edhe parandalohen krejtësisht në mënyrë proaktive.

DIVERSITETI, DIFERENCA DHE GJITHËPËRFSHIRJA ARSIMORE - PRETENDIMI I GJITHËPËRFSHIRJES

Siç është përmendur tashmë, diskutimi rreth integritit në shkollë kryesisht sillet rreth pyetjes se si fëmijët me nevoja të veçanta fizike, mendore ose shoqërore mund të “integrohen” në klasat normale. Kjo e bën të vështirë distancimin nga një pikëpamje e orientuar nga deficitet e nxënësve në fjalë. Ky lloj diskutimi rreth diferencës dhe diversitetit shpesh është “mbërthyer” te fëmijët me nevoja të veçanta.


Nga ana tjetër, pretendimi i gjithëpërfshirjes është më gjithëpërfshirës. Të menduarit gjithëpërfshirës analizon të përbashkëtat dhe diferencat, barazitë dhe pabarazitë, dhe homogjenitetin dhe heterogjenitetin në nivelin sistemik. Gjithëpërfshirja kërkon të shtrijë kufijtë e nocionit tonë se kush përcaktohet si pjesë e normës.

Veçantitë dhe nevojat e të gjithë nxënësve në një grup mësimor duhet pra të jenë objekt shqyrtimi. Kjo do të thotë që fokusi kryesor është te sistemi, jo tek zvogëlimi dhe alokimi i karakteristikave dhe kategorive diferencuese të individëve të ndryshëm.

Në planin afatgjatë, kategoritë individuale të diferencimit nuk mund të përshkruajnë kurrë në mënyrë adekuate, e lëre më të përcaktojnë, njerëzit në tërësinë e tyre. Sidoqoftë, kapërcimi i kategorive të diferencës nuk duhet të barazohet me një zbehje të plotë të diferencave që lidhen me mësimdhënien dhe arsimin nëse potencialet individuale dhe talentet e të gjithë nxënësve do të aktivizohen dhe promovohen në mënyrën më të mirë të mundshme.

Prandaj nuk bëhet fjalë as për “egalitarianizëm” as për fiksimin e aspekteve të diferencës. Në kontekstin e një shkolle gjithëpërfshirëse, ka të bëjë me aftësimin e të gjithë nxënësve për të mësuar së bashku në diversitet.

Për të kuptuar më mirë diversitetin në kontekstin shkollor, mund të ndihmojë një model i diversitetit me tri nivele të rëndësisë për kontekstin shkollor. Qëllimi i modelit është të ndihmojë zhvillimin e të kuptuarit themelor mbi të cilin ndërtohet mësimdhënia gjithëpërfshirëse dhe e ndjeshme ndaj diversitetit.



Identiteti personal: dimensionet e brendshme të pandryshueshme dhe të jashtme të ndryshueshme

Modeli bën dallimin midis dimensionit “të brendshëm” të pandryshueshëm dhe dimensionit “të jashtëm” të ndryshueshëm të aspekteve të diversitetit.

Njeriu lind në kategoritë e brendshme dhe këto nuk mund të ndryshohen ose mund të ndryshohen vetëm me vështirësi. Kategoritë e jashtme mund të ndryshohen nga vetë individi ose përmes ndërveprimit me mjedisin e tij.

Të kuptuarit e ndjeshëm ndaj diversitetit i arsimit dhe mësimdhënies përkatëse ka për detyrë forcimin dhe aftësimin. Nxënësit duhet të jenë në gjendje të marrin përgjegjësi për veten e tyre në dimensionin e jashtëm dhe të ndryshojnë atë që mund dhe duhet të ndryshohet.

Me personalitetin në qendër, qëllimi është të ilustrim se zhvillimi i personalitetit të një personi është një proces vetë-aktiv që rrjedh vazhdimisht dhe asnjëherë nuk kompletohet. Njerëzit me vetëdije vendosin pro dhe kundër përkatësive dhe modeleve të identifikimit. Modeli i diversitetit na fton të kuptojmë personalitetin si një kombinim individual të përkatësive që janë shfaqur në jetën e kësaj bote.

Kombinimi individual i përkatësive, identifikimeve dhe gjurmëve dhe preferencave që rezultojnë i bën nxënësit unik. Të përbashkëtat, si dhe diferencat shpesh jepen vetëm nga pikëpamja e situatave ose ajo kontekstuale, kështu që të përbashkëtat dhe diferencat mund të gjenden gjithmonë midis nxënësve.

ÇFARË ËSHTË MIRË TË REFLEKTOHET

NEVOJA PËR T'U PËRBALLUR ME VETVETEN

Ballafaqimi me biografinë e një personi është i një rëndësie të veçantë për njerëzit në fushat e praktikës arsimore. Të kuptuarit e veprimeve aktuale kundrejt përkatësisë së historisë jetësore të vetë individit dhe njohja e kontekstit të tyre të përgjithshëm është një mënyrë për të gjetur identitetin e vet.

Pranimi dhe të kuptuarit e historisë jetësore të vetë individit mundëson që të zhvillohet një qëndrim i theksuar ndaj vetvetes. Kjo ofron një potencial të madh për rritje dhe zhvillim personal, p.sh. duke zhvilluar shkathtësi dhe perspektiva të reja për veprim.

Përtej njohjes së historisë individuale, vetë-reflektimi biografik mundëson të kuptuarit të kushteve sociale (kornizës) së bashku me përvojat e veta. Përmes këtij të kuptuari të konteksteve shoqërore në kontekstin e situatave jetësore të vetë individit, aftësia për të adaptuar një perspektivë të të kuptuari në lidhje me të tjerët mund të mprehët në mënyrë të konsiderueshme.

Pyetjet për reflektim:

- ▶ Cila është norma ime?
- ▶ Nga çfarë të orientohe?
- ▶ Si mund t'i shikoj diferencat?
- ▶ Si mund të sillem përpara diferencës?
- ▶ Çfarë tërheqje ka diferenca për mua?
- ▶ A është diferenca kërcënim për mua?
- ▶ Sa i aftë për diferencim jam?
- ▶ Cila është pozita ime për diversitetin? Si mund të arrij të merrem me "pluralitetin e pamundur"? A mund ta shoh dhe shfrytëzoj potencialin në të?
- ▶ Cilat janë vlerat e mia personale dhe në çfarë mase ndikojnë idetë e mia për atë që është e drejtë/e gabuar, e mirë/e keqe, normale/jonormale në pikëpamjen time për nxënësit dhe kolegët?
- ▶ Me cilat syze i shikoj nxënësit/kolegët/menaxhmentin e shkollës/prindërit?

QËNDRIMI, IMAZHI NJERËZOR DHE TË KUPTUARIT E PROFESIONIT

Jetësimi i gjithëpërfshirjes kërkon që shkollat:

Ta shijojnë diversitetin, njohin atë, vlerësojnë atë dhe të janë të ndjeshëm ndaj kategorizimit. Gjithëpërfshirja nuk ka të bëjë vetëm me një grup specifik të fëmijëve dhe të rinjve, por me të gjithë nxënësit. Kjo do të thotë që shkollat:

- ▶ Vazhdimisht të përqendrohen në heqjen e pengesave për të mësuar dhe marrë pjesë. Gjithëpërfshirja nënkupton pjesëmarrjen në sferat njohëse, shoqërore dhe kulturore. Gjithëpërfshirja bazohet në të drejtën e të gjithë fëmijëve për të fituar të mësuarit.
- ▶ T'i thonë lamtumirë besimit në efektivitetin afatgjatë të grupeve homogjene të të mësuarit.

- ▶ Të mendojnë nga pikat e forta të nxënësve dhe t'u ndihmojnë në forcimin e personalitetit të tyre. Ndërtimi i një vetë-koncepti pozitiv krijon vetëbesim dhe qëndrueshmëri.
- ▶ Të mundësojnë pjesëmarrje kuptimplote përmes fuqizimit, vetëvendosjes dhe bashkë-përcaktimit.
- ▶ Demokracia në baza ditore dhe të janë të vetëdijshme për përgjegjësinë e tyre ndaj një shoqërie në zhvillim, në të cilën të gjithë zërat dëgjohen.
- ▶ Me vetëdije të bëjnë çështjet shoqërore temë e mësimave dhe kështu të mundësojnë diskutime, miratimin e perspektivave dhe aftësinë e nxënësve për të treguar solidaritet.
- ▶ Janë të gatshme të punojnë në ekipe multi-profesionale dhe në rrjet.

Pyetjet për reflektim:

- ▶ Cili është qëndrimi imë ndaj diversitetit? Si mund të arrij të merrem me atë? A mund ta shoh potencialin në të dhe ta shfrytëzoj atë?
- ▶ Cilat janë vlerat e mia personale dhe në çfarë mase ndikojnë idetë e mia për atë që është e drejtë/e gabuar, e mirë/e keqe, normale/jonormale në pikëpamjen time për nxënësit dhe kolegët?
- ▶ Në cilat norma dhe ide të normalitetit e mbështes punën time pedagogjike?
- ▶ Cilin imazh ideal, cilat ide të një nxënësi kam në mendje? A orientohem drejt “nxënësve mesatarë”?
- ▶ Si të merrem me faktin që vetë shkolla prodhon diferencë? Cili është qëndrimi imë ndaj saj?
- ▶ Cilat i shoh si aspektet më të rëndësishme të rolit tim si mësimdhënës?
- ▶ Cili ishte imazhi mbizotërues i fëmijës gjatë arsimit tim? Si mund të ndryshojë ky imazh nga një këndvështrim bashkëkohor i nxënësve dhe nevojave të tyre arsimore?
- ▶ Cilat kompetenca u nevojiten nxënësve për të qenë në gjendje të marrin pjesë në një shoqëri gjithnjë e më komplekse?
- ▶ Cilat formulime ose rituale që përqendrohen në pikat e forta të nxënësve dhe ndjenjën e arritjeve janë pjesë e jetës së përditshme të klasës?
- ▶ Si e trajtoj/më unë/ne diversitetin në hapësirën e personelit?
- ▶ Cilat forma të bashkëpunimit me prindërit dhe profesionistët e jashtëm tashmë po ndodhin?

NIVELI I MARRËDHËNIES PEDAGOGJIKE

Një marrëdhënie e besueshme e bazuar në besimin e ndërsjellë është “terreni ideal” për procese të suksesshme pedagogjike. Në të njëjtën kohë, marrëdhënia midis mësimdhënësve dhe nxënësve karakterizohet nga dilema e çekuilibrit hierarkik, p.sh. përmes përshkrimit të strukturave dhe përmbajtjes, si dhe fuqisë për të vendosur sanksione përmes dhënies së notave dhe caktimit të kufijve. Reflektimi mbi këto pabarazi shumëdimensionale të fuqisë dhe trajtimi i tyre me përgjegjësi është një sfidë e veçantë me të cilën përballen mësimdhënësit kur përpiqen për një nivel të respektimit horizontal në marrëdhëniet e tyre me nxënësit.

Respektimi horizontal lind në bazë të barazisë së perceptuar. Ai shprehet në faktin se dikush e trajton homologun e vet si të barabartë në parim dhe për këtë arsye gjithmonë merr parasysh dëshirat e tyre dhe përkufizimin e së vërtetës në veprimet e veta individuale. Ky të kuptuar i respektimit dallon nga “respektimi vertikal” i cili bazohet në strukturat hierarkike dhe kështu nga diferenca e perceptuar.

Pyetjet për reflektim:

- ▶ A kemi nivel të qëndrueshëm të marrëdhënies miqësore me nxënësit?
- ▶ A fokusohemi në masat e ndërtimit të besimit siç janë transparenca, inkurajimi dhe pranimi?
- ▶ Apo a përqendrohemi kryesisht tek performancë dhe kontroll?
- ▶ A jemi në një shkollë miqësore me njerëz me një klimë pozitive të mësimnxënies?
- ▶ Çfarë është respektimi horizontal në praktikën time të përditshme?
- ▶ Kur i arrij kufijtë e respektimit tim horizontal?
- ▶ Si e përjetojnë çekuilibrin hierarkik nxënësit tanë?

PESË PARIME PËR MËSIMDHËNIEN E NDJESHME NDAJ DIVERSITETIT NË SHKOLLAT NORMALE GJITHËPËRFSHIRËSE

Mësimi gjithëpërfshirës dhe i ndjeshëm ndaj diversitetit mund të shihet në aplikimin e pesë parimeve si mbështetje e 'listës së kontrollit' për reflektimin e mësimdhënësve:

- a. Kompetencat dhe strategjitë e diversitetit të mësimdhënësve:
Të kuptuarit e dialektikës së diferencës dhe barazisë formon bazën për zhvillimin e strategjive dhe kompetencave të veprimit të mësimdhënësve.
- b. Analiza e kushteve të mësimdhënies dhe mësimnxënies:
Një diagnozë e mësimnxënies pedagogjike gjithmonë përqendrohet në kushtet e ndërsjella ndërmjet nxënësve, kushteve të mësimdhënies dhe mësimnxënies dhe gjithmonë duhet të ketë një efekt në dizajnimin e mësimdhënies.
- c. Zgjidhja e problemit të përbashkët:
Në shkollat gjithëpërfshirëse, mësimdhënësit me kualifikime të ndryshme specifike punojnë në strukturat ekipore që mundësojnë përgjegjësi të përbashkëta në nivelin udhëzues.
Gjithëpërfshirja gjithashtu do të thotë që kufijtë jo vetëm midis kategorive të diferencës, por edhe midis disiplinave lëndore, lëndëve dhe njohurive të ekspertëve duhet të pasqyrohen në mënyrë kritike dhe të bëhen të përshkueshme kurdo që të jetë e mundur.
- d. Klima përshtatëse dhe mbështetëse e mësimnxënies:
Analiza e kushteve të mësimdhënies-mësimnxënies në komunitetin e mësimnxënies çon në mësimnxënie të individualizuar në komunitet. Të kuptuarit e ndryshëm të rolit të mësimdhënësit dhe zgjerimi i metodave të mësimdhënies është parakushti për zbatimin e suksesshëm. Larg udhëzimeve të pastra, drejt moderimit dhe mbështetjes për të mësimnxënie.
- e. Përqendrimi në komunitetin e mësimnxënies:
Mësimnxënia e mirë lidhet me një strukturë që refuzon të përzgjedhë fëmijët sipas performancës, origjinës sociale, përkatësisë etnokulturore, aftësisë së kufizuar dhe karakteristikave të tjera individuale dhe dëshiron të sigurojë mundësi të barabarta për të gjithë.

Pyetjet për reflektim:

- ▶ Në cilat aspekte të diversitetit përqendrohem si prioritet?
- ▶ Cilat aspekte të diversitetit i perceptoj si mundësi dhe pasuri dhe cilat si pengesa dhe probleme?
- ▶ Cilat aspekte të diversitetit nuk kanë luajtur ende ndonjë rol në mësimdhënien time?
- ▶ Çfarë ndryshimesh kam aplikuar tashmë në mënyrë që proceset e individualizimit dhe ofertat e diferencimit të mund të kenë sukses mirë?
- ▶ Cilat materiale dhe forma të mësimnxënies janë provuar të suksesshme për sa i përket individualizimit dhe diferencimit?
- ▶ Si mund të zbatoj metoda të tjera nga ana e mësimnxënies në klasë?
- ▶ Çfarë zgjedhjesh dhe vendimesh kanë fëmijët në lidhje me organizimin e kohës së tyre?
- ▶ Si mund t'u lejojmë nxënësve kohë të mësojnë me ritmin e tyre?
- ▶ Si mund të kontribuoj konkretisht në zhvillimin e një kulture mësimore të mbështetjes reciproke?
- ▶ Cilat mjedise (të mësimnxënies) kërkojnë shkathtësi veçanërisht të larta shoqërore?
- ▶ Si mund të ndaj kufizimet e ngurta të kohës në favor të një orari fleksibël ditor?
- ▶ Çfarë burimesh kohore mund të fitohen përmes bashkëpunimit të mësimdhënësve?

PRANIMI I DIVERSITETIT - MUNDËSIMI I PJESËMARRJES - FORMËSIMI I IDENTITETIT (PRAKTIKË)

Shkollat kanë për detyrë të edukojnë nxënësit e tyre që të bëhen qytetarë të përgjegjshëm, përveç pajisjes me kualifikimet e nevojshme. Që të rinjtë të zhvillojnë të kuptuarit e demokracisë dhe, si pasojë, të kuptojnë,

respektojnë dhe njohin kushtetutën tonë dhe rendin themelor demokratik, përvojat pozitive të qasjeve gjithëpërfshirëse çdo ditë kërkohen sa i përket pjesëmarrjes shoqërore. Nxënësit duhet të përjetojnë që mendimi i tyre të dëgjohet dhe të ketë peshë.

Në funksion të kësaj, duhet të parashtrihen dy pyetjet vijuese:

- ▶ Sa shpesh këto ideale dhe vlera bëhen vërtet të prekshme për nxënësit në kontekstin e jetës së përditshme shkollore?
- ▶ Çfarë i ofrojnë shkollat brezit të ardhshëm sa i përket zhvillimit të vetëvendosjes dhe solidaritetit?

Pjesëmarrja është përfshirja dhe pjesëmarrja e jetësuar në shoqëri, bazuar në njohuritë e të qenit në gjendje dhe e lejuar për të kontribuar në mënyrë aktive. Kështu që, përvoja gjithëpërfshirëse e pjesëmarrjes është çelësi për zhvillimin e tolerancës, bashkëpunimit dhe identifikimit me persona, grupe dhe sisteme.

Tabela e mëposhtme tregon një përmbledhje të qëllimeve, përmbajtjes dhe masave të mundshme të mësimdhënies dhe zhvillimit të shkollës të ndjeshme ndaj diversitetit.

Pyetjet për reflektim:

- ▶ A e përjetojnë nxënësit, mësimdhënësit dhe stafi shkollën si një hapësirë të sigurt, pa frikë, ku ata mund të ndihen rehat?
- ▶ Si trajtohet diskriminimi dhe konflikti?
- ▶ A ka një qëndrim vlerësues ndaj qëndrimeve të ndryshme politike, fetare ose kulturore të të rinjve?
- ▶ Cilat projekte dhe aktivitete i ndihmojnë nxënësit të përjetojnë ngjashmëritë dhe të përbashkëtat?
- ▶ A ka organe përfaqësuese funksionale në shkollë?
- ▶ A e shohin mësimdhënësit veten si luftëtarë të vetmuar apo si ekip?
- ▶ A ka ndonjë deklaratë apo program të misionit shkollor?
- ▶ A munden nxënësit të shprehin aftësitë e tyre në raste të veçanta (festivale sportive, shfaqje teatrale, ekspozita fotografike dhe arti, etj.)?
- ▶ Në cilat festivale mund të festojnë të gjithë fëmijët së bashku?
- ▶ Çfarë mundësish kanë nxënësit për të ndihmuar në dizajnimin e klasave?
- ▶ Si e pasqyron shkolla diversitetin e njerëzve që kalojnë kohë atje?
- ▶ A janë të gjithë kolegët të barabartë dhe a ndahet përgjegjësia?
- ▶ Cilat masa u përcjellin prindërve se ata janë të mirëseardhur në shkollë?
- ▶ Për cilat shërbime dhe shërbime mbështetëse familjare për prindërit dhe fëmijët kam njohuri?
- ▶ Në çfarë forme mund të shfrytëzohet ofertat kulturore në afërsi të shkollës? Çfarë kriteresh përdor për t'i përzgjedhur ato?

SI TË PLANIFIKONI MIRË: GJASHTË HAPA DREJT PLANIFIKIMIT TË MËSIMEVE GJITHËPËRFSHIRËSE

HYRJE

Mësimdhënia gjithëpërfshirëse kërkon planifikim dhe përgatitje të veçantë. Çelësi i suksesit është analizimi i proceseve të mësimnxënies së nxënësve tuaj dhe bërja e tyre pikënisje për planifikimin tuaj. Përmes dokumentimit të procesit të mësimnxënies dhe reflektimit mbi të, ju lidheni drejtpërdrejt me nivelin e arritjeve të nxënësve kur planifikoni përsëri. Kjo ju mundëson të mbështesni secilin fëmijë në nivelin e duhur. Mësoni këtu se si të planifikoni, përgatitni dhe reflektoni mbi mësimet gjithëpërfshirëse në 6 hapa.

Planifikimi i mësimve gjithëpërfshirëse përqendrohet edhe më shumë tek nxënësi individual. Qëllimi është që ata gjithnjë e më shumë ta përfytyrojnë veten si përgjegjës për procesin e tyre të mësimnxënies, të vendosin qëllimet e tyre dhe të njohin që mësimnxënia e tyre është e qëllimshme.

Në mënyrë që të arrihet rritja e mësimnxënies, secili nxënës duhet të jetë në gjendje të lidhet me përvojat e tij ose të saj të mëparshme, modelet e mendimit dhe idetë. Në këtë mënyrë, ata fitojnë njohuri të reja dhe zgjerojnë njohuritë e tyre. Si mësimdhënës, ju caktoni kursin për mësimnxënien e suksesshme. Në këtë mënyrë, ju planifikoni mësimet tuaja gjithëpërfshirëse hap pas hapi, duke marrë parasysh nevojat e të gjithë nxënësve:

HAPI 1: PRANONI REALITETIN E HETEROGJENITETIT

Termi heterogjenitet e ka zanafillën në mbiemrin grek heterogénés, i cili përbëhet nga fjalët heteros (= ndryshe) dhe gennáo (= krijoj, gjeneroj). Në kontekstin pedagogjik, heterogjenitet do të thotë shumëllojshmëri e nxënësve në lidhje me një ose më shumë karakteristika. Prandaj, grupet heterogjene të mësimnxënies nuk i referohen asgjë më shumë se një grupi nxënësish me karakteristika të ndryshme.

Secili nxënës është unik në mënyrën e tij ose të saj. Nëse shikoni një klasë, fëmijët ndryshojnë në shumë karakteristika individuale. Sigurohuni që planifikimi juaj të marrë parasysh karakteristikat:

- ▶ Njohuritë baze: Nxënësit vijnë në shkollë me njohuri dhe kërkesa të ndryshme për të mësuar. Aftësia e tyre heterogjene reflektohet në atë që ata mësohen dhe si funksionojnë.
- ▶ Interesat: Heterogjeniteti mund të gjendet në interesat e fëmijëve. Një fëmijë ka shkathtësi të shkëlqyera në matematikë, por ka boshllëqe të mëdha në fjalor dhe gramatikë. Tjetri interesohet për artin, por jo për temat historike.
- ▶ Shtigjet e mësimnxënies: Nxënësit mund të kenë një temë ose të përmbledhin rezultatet e punës në mënyra të ndryshme. Shtigjet e tyre të mësimnxënies janë të ndryshme.
- ▶ Sjellja e mësimnxënies dhe punës: Ka lloje të ndryshme të nxënësve. Disa nxënës kanë një talent të madh për organizim, të punojnë në një mënyrë të orientuar drejt qëllimit dhe të menaxhojnë saktë kohën e tyre të punës. Të tjerët kanë më pak qëndrueshmëri dhe përqendrim: ata hallaviten, shpërqendrohen shpejt ose humbin guximin për të vazhduar punën.
- ▶ Përkatësia kulturore dhe shoqërore: Fëmijët gjithashtu ndryshojnë në përkatësinë e tyre shoqërore. Kështu, në grupe heterogjene të mësimnxënies, bashkohet një shumëllojshmëri e gjerë kulturash me pikëpamje, gjuhë, tradita dhe stile të ndryshme jetese fetare.

- ▶ Përvojat: Çdo nxënës vjen në shkollë me një përvojë individuale jetësore dhe histori jetësore.
- ▶ Motivimi: Nxënësit gjithashtu kanë nivele të ndryshme të motivimit për të mësuar. Disa pëlqejnë të mësuarit, të tjerët kanë më shumë të ngjarë të përjetojnë zhgënjim gjatë të mësuarit në vend që të mësojnë me kënaqësi.

Dimensionet e ndryshme të heterogjenitetit tregojnë një gjë mbi të gjitha: diversiteti i fëmijëve ka një ndikim vendimtar në atë që ndodh në klasë. Çdo ditë rishtas, mësimmhënësit duhet të përballen me sfidën e plotësimit të nevojave të fëmijëve. Secili nxënës individual duhet të mbështetet në përputhje me aftësitë e tij ose të saj. Por kjo nuk është një detyrë e lehtë - në fund të fundit, askush nuk duhet të mbi-sfidohet ose nën-sfidohet. Pasoja për përgatitjen e mësimit është pra: një larmi mundësish për të mësuar janë në dispozicion dhe u mundësojnë nxënësve të hyjnë në procesin e mësimmxënies përmes dyerve të ndryshme.

HAPI 2: DIAGNOSTIFIKIMI NË KLASË

Në Hapin 1, ju jeni veçanërisht të sfiduar në shkathtësitë tuaja personale të vëzhgimit dhe interpretimit. Vlerësimet e nivelit të mësimmxënies në fillim dhe gjatë vitit shkollor japin informacion në lidhje me nivelin e performancës së secilit nxënës individual. Gjithashtu, kushtojini rëndësi vëzhgimit sistematik të nxënësve. Një tabelë e thjeshtë me hapësirë të mjaftueshme për shënime, të cilin mund ta keni shpejt në dorë, është një ide e mirë.

Pyetjet e mëposhtme janë të dobishme për vëzhgimin e nxënësve të orientuar në proces:

- ▶ Cilët janë pikat e forta të nxënësit?
- ▶ Çfarë di tashmë nxënësi për momentin?
- ▶ Cili duhet të jetë hapi tjetër në zhvillimin e mësimmxënies së tij?
- ▶ Me cilat shqisa/media nxënësi mëson më lehtë?
- ▶ Cilat mjete/mbështetje i nevojiten atij për këtë?

HAPI 3: DOKUMENTIMI I ZHVILLIMIT TË MËSIMXËNIES

Kërkon menaxhim të mirë të kohës nëse dëshironi të bëni vëzhgim sistematik, kuptimplotë të nxënësit përveç mësimmhënies. Kjo është ajo ku ju mund të përfitoni nga mësimmhënësia në ekip: Diskutoni këtë aspekt në detaje me ekipin tuaj multi-profesional, ose kërkoni mbështetje nga ekipi i nivelit të vitit. Planet e zhvillimit të mësimmxënies zhvillohen më së miri së bashku. Si rregull, ju do të merrni qëllime zhvillimore për fushat: shkathtësitë të lidhura me lëndën, kompetencat metodologjike dhe vetë kompetencat, si dhe sjelljet.

Në fillim, duket e frikshme të kalosh një përpjekje të madhe për krijimin e një plani zhvillimor për secilin nxënës individual. Sidoqoftë, mos harroni lehtësimin organizativ dhe emocional që sjell kur nxënësit tuaj mësojnë të pavarur dhe me sukses në nivelin e tyre personal të arritjeve.

HAPI 4: ÇAKTIMI I QËLLIMEVE SË BASHKU

Në mësimmxënien e vetë-drejtuar në arsimin gjithëpërfshirës, është me rëndësi të madhe përfshirja e vetë nxënësve në vendosjen dhe reflektimin mbi qëllimet. Ky është një proces mësimmor për ju si mësimmhënës dhe për vetë nxënësit. Është thelbësore të keni biseda ballë për ballë. Nxënësit që dinë se çfarë duan të gjejnë, njohin dhe kuptojnë në mësimet e ardhshme zakonisht punojnë në një mënyrë të orientuar drejt qëllimit dhe të motivuar. Sigurohuni që qëllimet të mbesin të vogla dhe të menaxhueshme. Nxënësit tuaj do ta përjetojnë veten si të vetë-efektshëm vetëm nëse i shohin qëllimet e dakorduara si të arritshme.

HAPI 5: REFLEKTONI MBI PROCESIN E MËSIMXËNIES

Është e rëndësishme për mësimmhënien gjithëpërfshirëse që nxënësi të planifikojë projektin e vet të mësimmxënies së bashku me ju. Baza për këtë janë gjetjet tuaja diagnostike dhe ato që janë arritur deri më tani. Njoftojini nxënësit me këtë mësimmxënien të pavarur hap pas hapi. Fëmija duhet të dijë se çfarë saktësisht supozohet të mësojë dhe me cilin material mund ta arrijë këtë. Ata sigurisht që do të kenë nevojë për mbështetje në këtë drejtim.

Planet e punës që hartohen sipas orës, ditës dhe më vonë sipas javës janë më të përshtatshme. Tashmë kur formuloni qëllimin e mësimnxënies, është thelbësore që nxënësve t’u jepen indikacione për atë që ai/ajo duhet të bëjë për të arritur rezultatet:

- ▶ e pafavorshme: Ana supozohet se zotëron “shumëzimin” aritmetik bazë në matematikë.
- ▶ e favorshme: Ana e formulon vetë qëllimin e vet: “Unë dua të di tabelën e shumëzimit me katër.”

1. Unë praktikoj tabelat e shumëzimit me ‘4’
2. Po mësoj përmendësh tabelën e shumëzimit me ‘4’.
3. Unë praktikoj detyra me ngjyra të përziera (nga libri i matematikës faqe 27).

Sa më i përfshirë të jetë nxënësi juaj në planifikim, aq më lehtë do të jetë për ata që të punojnë të pavarur. Kjo gjithashtu përfshin material të strukturuar mirë dhe një klasë të organizuar. Për të qenë në gjendje të mësojë në mënyrë të pavarur, Ana duhet të dijë:

- ▶ Cili material është menduar?
- ▶ Ku mund ta gjej materialin?
- ▶ Çfarë të bëj nëse një fëmijë tjetër po punon tashmë me të?
- ▶ Si mund të punoj me materialin?
- ▶ Si t’i kontrolloj rezultatet e mia?
- ▶ Ku ta rregulloj përsëri?

Shembull i një plani zhvillimi të mësimnxënies

Emri i nxënësit: Ana **Periudha: Janar-mars**

lënda	kompetenca	qëllimi	materialet	reflektimi
Gjuha amtare	lexon rrjedhshëm	Ana duhet të lexojë rrjedhshëm fjalë të thjeshta pa hezitim	- Leximi i Librit ‘Dita me Diell’ Faqet 6 - 10 - Leximi i lojës nr. 3 - Leximi i kartave nr. 1	Mars 25: Ana lexon 11 nga 20 (më parë 4 nga 20) fjalë pa gabime, pa hezitim. Këshilla mbështetëse: Për të përmirësuar në mënyrë të qëndrueshme, shtoni 2 ushtrime shtesë çdo javë.
Matematikë	shumëzim	Ana duhet të jetë në gjendje të zotërojë tabelat e shumëzimit me 2 dhe 4.	Tabela e shumëzimit me 2: - Kartat mësimore nga kutia 2 - Libri i matematikës faqet 16 - 21 - Materialet e trajnimit 4 - 8	Mars 28: Ana po zgjidh llogaritjen e tabelës 2 pa gabim edhe rastsisht
			Tabela e shumëzimit me 4: - Kartat mësimore nga kutia 4 - Libri i matematikës faqet 24 - 26 Materialet e trajnimit 12 - 15	Mars 28: Meqenëse Ana përzien rezultatet nga llogaritjet e tabelës së shumëzimit me 2 dhe 4, ajo ende ka nevojë për të trajnuar veçmas llogaritjet e tabelës me 4. Nevojiten materiale shtesë për trajnim.


HAPI 6: DOKUMENTIMI I REZULTATEVE PËRFUNDIMTARE TË MËSIMNXËNIES

Ditarët, regjistrat dhe portfoliot mësimore janë veçanërisht të përshtatshëm për dokumentimin e proceseve të mësimnxënies individuale të nxënësve dhe për vlerësimin e rregullt të tyre. Këto përqendrohen në qëllimet e arritura të mësimnxënies dhe mbështesin nxënësin në vetë-reflektim. Në fund të fazave të hapura të mësimnxënies, duhet të keni një sesion reflektimi me nxënësit tuaj. Fëmijët paraqesin shkurtimisht qëllimin për të cilin kanë punuar, sa afër arritjes së qëllimit sot, si e kanë arritur atë dhe si do të vazhdojë puna. Gjithashtu adresoni punën dhe sjelljen shoqërore.

Këshillë praktike: Një gur, një gomë dhe një pendë mund të përdoren për ta paraqitur në mënyrë simbolike sa e vështirë ishte detyra e sotme. Një nxënës gjithashtu mund ta përdorë atë për të përshkruar një përmirësim më lehtë: *“Në fillim detyrat me minus ishin përsëri të vështira, por tani janë po aq të vështira sa goma.”* Për reflektim, praktikoni blloqe fjalish me nxënësit për t’i ndihmuar ata të shprehin mendime në fjalë.

- ▶ *“Kam mësuar sot ...”*
- ▶ *“E vështirë për mua ishte ...”*
- ▶ *“E lehtë për mua është ...”*
- ▶ *“Herën tjetër dua të bëj ... më mirë”.*

PJESA B: KRRKD NGA KËSHILLI I EVROPËS



INFORMATA TË PËRGJITHSHME:

KËSHILLI I EVROPËS: NJË HISTORI E SHKURTËR E NJË INSTITUCIONI TË RËNDËSISHËM

Këshilli i Evropës, me selinë e tij të vendosur në Strasburg, Francë, u themelua në vitin 1949 dhe është organizata më e vjetër ndërqeveritare në Evropë me numrin më të madh të anëtarëve. Temat kryesore të tij janë mbrojtja dhe promovimi i të drejtave të njeriut, demokracia dhe sundimi i ligjit. Aktualisht ka 47 shtete anëtare me një popullsi totale prej mbi 800 milion njerëz.

Këshilli i Evropës është një forum për debat mbi çështjet e përgjithshme evropiane. Ai zhvillon marrëveshje ndërqeveritare të detyrueshme sipas ligjit ndërkombëtar, të tilla si Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, me qëllim të ruajtjes së trashëgimisë së përbashkët dhe promovimit të progresit ekonomik dhe shoqëror.

Një nga konventat më të rëndësishme të Këshillit të Evropës është Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ). Kjo u mundëson individëve të paraqesin ankesë në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut në Strasburg. Viktimat e një shkeljeje të të drejtave dhe garancive të përcaktuara në Konventë ose në njërën nga Protokollat e saj mund të paraqesin një ankesë në Gjykatën Evropiane të Drejtësisë. Shkelja duhet të jetë kryer nga një shtet nënshkrues i Konventës.

Përveç Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Këshilli i Evropës ka këto organe:

- ▶ Komiteti i Ministrave, i përbërë nga Ministrat e Punëve të Jashtme të 47 shteteve anëtare
- ▶ Asambleja Parlamentare, anëtarët e së cilës emërohen nga parlamentet kombëtare
- ▶ Kongresi i Autoriteteve Lokale dhe Rajonale, i cili përbëhet nga përfaqësues të autoriteteve lokale dhe rajonale në shtetet anëtare
- ▶ Konferenca e Organizatave Joqeveritare Ndërkombëtare, e cila përbëhet nga delegatë nga ato organizata që plotësojnë kriteret e akreditimit të Këshillit të Evropës

Zyra e Këshillit të Evropës në Prishtinë filloi aktivitetet e saj të bashkëpunimit në fushat e të drejtave të njeriut, sundimit të ligjit dhe demokracisë në vitin 1999. Që atëherë, Zyra ka lehtësuar vazhdimisht ofrimin e programeve të rëndësishme të mbështetjes drejt realizimit të standardeve të Këshillit të Evropës në praktikë për të gjithë njerëzit, duke ndihmuar institucionet kryesore në procesin e reformave të tyre demokratike.

Të nxitur nga një angazhim për të adresuar nevojat lokale, për të siguruar kontribute të vlerës së shtuar dhe forcimin e partneriteteve, Zyra e Këshillit të Evropës në Prishtinë koordinon në mënyrë aktive përpjekjet me të gjithë aktorët relevant vendor dhe ndërkombëtar në këtë fushë.

Bashkëpunimi deri më tani është përqendruar në ndërtimin e kapaciteteve të gjyqtarëve dhe prokurorëve mbi standardet evropiane të të drejtave të njeriut, mbështetjen e angazhimit efektiv të shoqërisë civile, mbështetjen e përpjekjeve të autoriteteve qendrore dhe lokale në sigurimin e arsimit gjithëpërfshirës cilësor, promovimin e diversitetit kulturor, sigurimin e mbështetjes së ekspertëve për zhvillimin e legjislacionit, përforcimin e institucioneve të pavarura siç është Institucioni i Avokatit të Popullit, forcimin e rolit të medias dhe punën në luftimin e krimit ekonomik dhe korrupsionit, dhe monitorimin e zgjedhjeve.

Edukimi për qytetari demokratike: një mënyrë e re për të kuptuar përgjegjësinë dhe të drejtat.

Pas përfundimit të Luftës së Ftohtë, disa procese të modernizimit që kishin formësuar historinë tonë për një kohë të gjatë papritmas filluan të përshpejtohen dhe të intensifikohen. Këto ngjarje dhe ndryshime që ndodhin në të gjithë Evropën kanë sfiduar modelin tradicional të qytetarisë:

Globalizimi i tregtisë së lirë dhe ekonomive të tregut konkurrues ka sjellë një nivel më të lartë të mirëqenies për shumë njerëz në të gjithë botën, por jo për të gjithë. Hendeku i shpërndarjes së pabarabartë midis të pasurve dhe të varfërve është rritur, si brenda dhe midis komuniteteve, duke kërcënuar kohezionin social dhe solidaritetin midis njerëzve.

Konkurrenca i shtyn ndërmarrjet të rrisin përgjithmonë produktivitetin e tyre dhe të ulin kostot e tyre të prodhimit. Kjo i ka dhënë shkas një procesi të përhershëm të inovacionit, duke prekur drejtpërdrejt produktet, teknologjinë dhe vendet e punës, dhe indirekt duke ndikuar në të gjithë mënyrën tonë të jetesës.

Rritja ekonomike ka sjellë rritjen e mirëqenies, por edhe rritjen e konsumit të burimeve natyrore. Rritja e emetimeve të CO₂ e bën gjithnjë e më të vështirë dhe të kushtueshme shmangien, ose përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike.

Teknologjitë e reja të informacionit dhe komunikimit kanë siguruar mënyra të reja për të rritur produktivitetin, për të shkëmbyer dhe marrë informacion, dhe për të ofruar argëtim, së bashku me shumë gjëra të tjera. Ne jetojmë në një kulturë mediatike, dhe shkrim-lexim mediatik - si të përdorim mediat e reja si për krijimin dhe marrjen e mesazheve - po bëhet një shkathtësi elementare si leximi dhe shkrimi.

Për shkak të rritjes ekonomike dhe arritjeve të mjekësisë moderne, popullsia në shumë vende evropiane po plakët, ndërsa po rritet në botë si një e tërë. Të dy zhvillimet paraqesin probleme serioze për shekullin 21.

Shoqëritë moderne janë tipike laike, shoqëri pluraliste. Migrimi në të gjithë Evropën ka kontribuar në këtë zhvillim. Shoqëritë pluraliste janë më dinamike dhe produktive, por gjithashtu janë më kërkuese për sa i përket kohezionit shoqëror në mënyrë që të integrojnë njerëz me besime, vlera, interesa dhe prejardhje shoqërore dhe etnike të ndryshme.

Demokracia na ofron shanset më të mira për të përmbushur këto sfida, pasi çdo përpjekje për të zgjidhur këto dhe probleme të tjera përmes sundimit autoritar do të dështojë të marrë në konsideratë realitetin kompleks të shoqërisë, ekonomisë, mjedisit, zgjidhjes së konflikteve, etj. në nivel kombëtar, e lëre më në atë mbikombëtar. Nga ana tjetër, demokracia ngrihet dhe bie me zotimin e pjesëmarrjes së barabartë. Sa më komplekse të bëhet bota jonë dhe sfidat që përcaktojnë të ardhmen tonë, aq më e vështirë është për "qytetarin e rëndomtë" të kuptojë dhe të marrë pjesë në vendimmarrje. Mosbesimi ndaj institucioneve tradicionale politike, formave të qeverisjes dhe udhëheqësve politikë është rrënjosur në ndjenjën e të qenit të lënë anash dhe të mos dëgjuar. Demokracia dhe të drejtat e njeriut janë projekte të pasigurta dhe mbijetesa e tyre varet nga fakti nëse trashëgimia e tyre mund t'i kalohet brezit më të ri.

Përballë sfidave të tilla si këto, është bërë e qartë se kërkohen forma të reja të qytetarisë: qytetarët jo vetëm që duhet të informohen dhe të kuptojnë përgjegjësitë e tyre zyrtare si qytetarë, por edhe duhet të jenë aktivë; të aftë dhe të gatshëm të kontribuojnë në jetën e komunitetit të tyre, vendit të tyre dhe botës së gjerë, duke marrë pjesë aktivisht në mënyra që shprehin individualitetin e tyre dhe duke ndihmuar në zgjidhjen e problemeve. Sfidat në rritje kërkojnë shoqëri të forta me udhëheqës dhe qytetarë kompetentë - dhe për këtë arsye të arsimuar siç duhet. Dhe familjet janë qendrat në të cilat fëmijët përjetojnë atë që do të thotë të jetosh së bashku çdo ditë. Deri më tani, familjet kanë ekzistuar në shumë forma dhe rrethana, dhe të gjitha nën lloje të ndryshme të sistemit politik. Ajo që është e rëndësishme të thuhet këtu është që edukimi i fëmijëve në një shoqëri demokratike duhet të ketë një qëllim të qartë: mësimi i fëmijëve dhe të rinjve të ushtrojnë të drejtat e tyre dhe të mbajnë pjesën e tyre të përgjegjësisë të përbashkëta.

KOMPETENCAT PËR KULTURË TË DEMOKRACISË:

Demokracia si strukturë kushtetuese e shtetit.

E para dhe më e rëndësishmja, demokracia është diçka në letër, e shkruar në kushtetutë. Në një demokraci, kushtetuta kuptohet si dokumenti kryesor ligjor i një shteti. Ai rregullon strukturën themelore organizative të shtetit, strukturën territoriale të shtetit dhe marrëdhëniet me shtetet përbërëse të tij. Ai gjithashtu regjistron marrëdhëniet midis qytetarëve dhe shtetit, dhe cilat të drejta dhe përgjegjësi aplikohen për ta. Kompetencat shtetërore të konstituara në këtë mënyrë janë të lidhura nga kushtetuta si norma supreme dhe pushteti i tyre mbi normën është i kufizuar. Në shtetet demokratike, fuqia krijues e kushtetutës buron nga njerëzit e shtetit. Kushtetutat zakonisht përmbajnë edhe detyra shtetërore dhe objektiva shtetërore; këto shpesh gjenden në një preambulë. Qëllimet thelbësore demokratike janë liria, barazia, drejtësia, siguria dhe mirëqenia, që përfshin njohjen e të drejtave njerëzore dhe civile, sovranitetin popullor përmes zgjedhjeve, parlamentarizmin, kontrollin parlamentar të pushtetit dhe ndarjen e pushteteve. Që qytetarët të jenë në gjendje të ushtrojnë të drejtat dhe detyrat e tyre politike, shteti duhet t'u garantojë atyre sigurimin themelor shoqëror.

Pasja e një kushtetute të drejtë në të cilën janë formuluar të gjithë elementët qendrorë të bashkëjetesës demokratike është padyshim një bazë e rëndësishme për një shoqëri të hapur. Sidoqoftë, përvoja e shumë qytetarëve në të gjithë botën tregon se ajo që është shkruar në letër nuk pasqyrohet gjithmonë në jetën reale. Çfarë kuptimi kanë nenet e kushtetutës për të jetuarit së bashku (demokracia si formë e shoqërisë) dhe jetën e përditshme të individit (demokracia si formë jetese) nëse nuk zbatohen në jetën reale?


Demokracia si shenjë e kulturës së komunitetit

Demokracia është shumë më tepër sesa thjesht një kushtetutë. Demokracia përfshin gjithashtu një dimension shoqëror: Demokracia është - me fjalë të tjera - një formë e shoqërisë. Shfaqja e demokracive "të reja" evropiane dhe globalizimi në rritje, i cili ka prekur kufijtë e shteteve ekzistuese, kanë treguar se demokracia nuk është e kufizuar në një sistem ligjor. Vetëm ancorimi shoqëror dhe transmetimi i parimeve demokratike mundësojnë funksionimin e sistemeve demokratike politike. Kjo mund të quhet kultura e përditshme e demokracisë. Ky kuptim kërkon një shoqëri të fortë civile në të cilën pluralizmi dhe ndryshimi shoqëror mund të ekzistojnë dhe konfliktet zgjidhen në mënyrë paqësore. Konkurrenca ekonomike, e realizuar në kushte të drejta, duhet gjithashtu të jetë e mundur në një shoqëri civile demokratike. Një publik i lirë dhe i larmishëm, i mbështetur nga një angazhim i gjerë qytetar, është një parakusht tjetër për shoqëritë demokratike. Nga perspektiva e kërkimit kulturor politik, një kuptim i tretë i demokracisë ishte i drejtuar drejt jetës së përditshme, drejt kulturës së bashkëjetesës sociale. Në vitet e fundit, psikologjia arsimore, filozofia dhe edukimi politik kanë aplikuar këtë qasje duke pyetur për bazat individuale dhe socio-morale të kuptimit politik të demokracisë: Si mund të bëhet e prekshme demokracia dhe si mund të rriten përvoja të tilla?

Kjo ka të bëjë me mikro-nivelin e kulturës demokratike, për shembull në secilën familje ose në lagje. Shihet si baza e angazhimit politik demokratik dhe shoqërive demokratike në përgjithësi. Sipas këtij këndvështrimi, kushdo që rritet në një mjedis të karakterizuar nga toleranca dhe drejtësia e kupton diversitetin e stileve të jetesës si një mundësi, është i arsimuar në solidaritet dhe vetë-organizim dhe ka parakushte të mira për të vepruar në mënyrë demokratike brenda shoqërisë dhe për të marrë pjesë në mënyrë demokratike në sistemin politik.

Këshilli i Evropës e zhvilloi Kornizën Referente të Kompetencave për Kulturë Demokratike. Modeli me 20 kompetenca, i zhvilluar brenda fushëveprimit të projekteve për demokracinë të Këshillit të Evropës, përshkruan se si vlerat e demokracisë zbatohen në shkolla dhe në jetën e përditshme. Në çdo situatë mësimnxënie, disa nga këto elemente janë të dukshme. Në çdo klasë shumë prej tyre tashmë janë duke u zbatuar, por ne si mësimdhënës shpesh nuk jemi në dijeni të tyre vetë.

Demokracia 'flutur' me 20 kompetenca



Modeli i kompetencës së Kornizës Referente të Kompetencave për Kulturën Demokratike (KRKKD), duke renditur 20 kompetencat që individët kërkojnë në mënyrë që të funksionojnë si qytetarë me kompetencë demokratike dhe ndërkulturore. Shpesh referuar si "flutura", modeli u zhvillua nga grupi *ad hoc* i ekspertëve për KRKKD-në dhe u miratua nga Ministri Evropian të Arsimit në prill 2016. Modeli, përshkruet e kompetencave dhe udhëzimet për zbatim së bashku përbëjnë KRKKD-në.

Një kulturë demokratike mbështetet në qytetarët që kanë vlerat, qëndrimet, shkathtësitë, njohuritë dhe të kuptuarit kritik të përshkruar në modelin e kompetencave më sipër. Prandaj, korniza ofron përshkruet të hollësishëm për secilën nga 20 kompetencat. Këto janë shkruar kryesisht për mësimdhënësit dhe nxënësit për të kuptuar dhe zbatuar praktikat demokratike në klasë dhe objektet shkollore.

Përshkruet e kompetencave janë deklarata që përshkruajnë sjelljet e vëzhgueshme që tregojnë kur një person ka arritur një nivel të caktuar të një kompetence të veçantë. Kjo është e rëndësishme për zhvillimin e një demokracie, sepse kur shohim kompetenca dhe përshkruet që zbatohen në jetën familjare, ne e dimë që shoqëria nuk është thjesht demokratike në letër, por që veprimet dhe rezultatet demokratike janë të vëzhgueshme në realitet. Familja është një vend i rëndësishëm trajnimi për këtë: fëmijët e përjetojnë demokracinë në veprim si pjesë e rutinës së tyre normale ditore.

Ky manual 'Brenda - Njohuri - Gjithëpërfshirje' - ju ofron jo vetëm kompetencat dhe përshkruet, por edhe një 'kopsht kompetencash' (shih faqen e fundit të këtij manuali). Ju dhe të gjithë lojtarët e tjerë kryesorë mund ta përdorni këtë poster për të zhvilluar një profil të demokracisë të klasës, shkollës, stafit tuaj etj.

Demokracia, siç interpretohet zakonisht, nënkupton një formë të qeverisjes nga ose në emër të njerëzve. Një tipar kryesor i qeverisjes së tillë është të jesh i përgjegjshëm ndaj pikëpamjeve të shumicës. Për këtë arsye, demokracia nuk mund të funksionojë në mungesë të institucioneve që sigurojnë përfshirjen e qytetarëve të rritur, organizimin e zgjedhjeve të rregullta, të kontestuara, të lira dhe të ndershme, sundimin e shumicës dhe llogaridhënien e qeverisë. Sidoqoftë, ndërsa demokracia nuk mund të ekzistojë pa institucione dhe ligje demokratike, vetë këto institucione nuk mund të funksionojnë nëse qytetarët nuk praktikojnë një kulturë demokracie dhe nuk mbajnë vlera dhe qëndrime demokratike. Ndër të tjera, këto përfshijnë: angazhim për diskutim publik, gatishmëri për të shprehur mendimet e veta dhe për të dëgjuar mendimet e të tjerëve, bindje që ndryshimet e mendimeve dhe konfliktet duhet të zgjidhen në mënyrë paqësore, angazhim për vendimet që merren nga shumica, angazhim për mbrojtjen e pakicave dhe të drejtat e tyre, njohje që rregulli i shumicës nuk mund të shfuqizojë të drejtat e pakicave, dhe angazhim për sundimin e ligjit.

Demokracia gjithashtu kërkon angazhimin e qytetarëve për të marrë pjesë aktivisht në fushën publike. Nëse qytetarët nuk u përmbahen këtyre vlerave, qëndrimeve dhe praktikave, atëherë institucionet demokratike nuk janë në gjendje të funksionojnë. Në shoqëritë e larmishme kulturore, proceset dhe institucionet demokratike kërkojnë dialog ndërkulturor.

Një parim themelor i demokracisë është që ata që preken nga vendimet politike mund të shprehin pikëpamjet e tyre kur merren vendimet, dhe që këto pikëpamje të merren parasysh nga vendimmarrësit. Dialogu ndërkulturor është, para së gjithash, mjeti më i rëndësishëm përmes së cilit qytetarët mund të shprehin pikëpamjet e tyre para bashkëqytetarëve me përkatësi të ndryshme kulturore. Së dyti, është mjeti përmes së cilit vendimmarrësit mund të kuptojnë pikëpamjet e të gjithë qytetarëve, duke marrë parasysh përkatësitë e tyre të ndryshme kulturore të vetë-përshkruara. Në shoqëritë e larmishme kulturore, dialogu ndërkulturor është thelbësor për të siguruar që të gjithë qytetarët të jenë njësoj të aftë për të marrë pjesë në diskutimet publike dhe proceset e vendimmarrjes. Demokracia dhe dialogu ndërkulturor janë plotësuese në shoqëritë e larmishme kulturore.

Vlerat janë besime të përgjithshme që individët kanë në lidhje me qëllimet që njerëzit duhet të përpiqen në jetën e tyre. Ato motivojnë veprimin dhe gjithashtu shërbejnë si parime udhëzuese se si të veprohet. Vlerat tejkalojnë veprime dhe kontekste specifike dhe ato kanë një cilësi normative përshkruese për atë që duhet të bëhet ose mendohet në një varg situatash. Vlerat ofrojnë standarde ose kritere për: vlerësimin e veprimeve, si të një personi ashtu edhe të personave të tjerë; justifikimin e mendimeve, qëndrimeve dhe sjelljeve; vendimmarrjen; planifikimin e sjelljes dhe përpjekjen për të ndikuar tek të tjerët.

Qëndrimi është orientimi i përgjithshëm mendor që një individ adopton ndaj dikujt ose diçkaje (për shembull një person, një grup, një institucion, një çështje, një ngjarje ose një simbol). Qëndrimet zakonisht përbëhen nga katër komponentë: një besim ose mendim në lidhje me objektin e qëndrimit, një emocion ose ndjenjë ndaj objektit, një vlerësim (qoftë pozitiv ose negativ) i objektit dhe një tendencë për t'u sjellë në një mënyrë të veçantë ndaj atij objekti.

Shkathtësia është kapaciteti për të kryer modele komplekse, të mirëorganizuar ose të të menduarit ose të sjelljes në një mënyrë adaptuese, në mënyrë që të arrihet një qëllim i veçantë përfundimtar. Ekzistojnë tetë grupe shkathtësish që janë të rëndësishme për një kulturë demokracie, siç renditen në faqet vijuese.

Njohuritë është trupi i informacionit që posedohet nga një person, ndërsa të kuptuarit është kuptimi dhe vlerësimi i kuptimeve. Termi «të kuptuarit kritik» përdoret për të theksuar nevojën për të kuptuar dhe vlerësuar kuptimet në kontekstin e proceseve demokratike dhe dialogut ndërkulturor për të përfshirë reflektimin aktiv dhe vlerësimin kritik të asaj që po kuptohet dhe interpretohet (në krahasim me interpretimin automatik, të zakonshëm dhe jo reflektues).

Nën të katër dimensionet (vlerat, qëndrimet, shkathtësitë, njohuritë dhe të kuptuarit kritik), Këshilli i Evropës ka zhvilluar përshkrues që ndihmojnë për të përshkruar veprimet e vëzhgueshme demokratike. Këto janë zhvilluar kryesisht për qëllime shkollore, por gjithashtu mund të jenë relevante dhe të rëndësishme në jetën e përditshme të një familjeje.

Si shembull, mund të shohim kompetencën 13 (ndjeshmëria). Ekzistojnë 6 përshkrues që tregojnë veprimet e paraqitura në një anëtar të familjes i cili ruan një ndjenjë të ndjeshmërisë në jetën e tyre të përditshme:

- ▶ Mund të njohë kur një shoqëruar ka nevojë për ndihmën e tij ose të saj.
- ▶ Shpreh simpati për gjërat e këqija që ai ose ajo ka parë të ndodhin tek njerëzit e tjerë.
- ▶ Mundohet të kuptojë më mirë miqtë e tij ose të saj duke imagjinuar se si duken gjërat nga këndvështrimi i tyre.
- ▶ Merr parasysh ndjenjat e të tjerëve kur merr vendime.
- ▶ Shpreh pikëpamjen se, kur ai ose ajo mendon për njerëzit në vendet e tjera, ai ose ajo ndan gëzimet dhe hidhërimet e tyre.
- ▶ Identifikon me saktësi ndjenjat e të tjerëve, edhe kur ata nuk duan t'i tregojnë ato.

Është e rëndësishme këtu të theksohet se elementet e Kornizës Referencë të Kompetencave për Kulturën Demokratike (KRKKD) nuk janë vetëm veprimet që prindërit ose edukatorët duhet të presin nga fëmijët ose të rinjtë. Ato gjithashtu duhet të vëzhgohen anasjelltas: Nëse vetë të rriturit nuk angazhohen në rritjen dhe mësimnxënien të bëhen qytetarë më të mirë demokratik (dështimet jo vetëm që lejohen, por konsiderohen si një pjesë normale e procesit të mësimnxënies), atëherë procesi i mësimdhënies së tyre as nuk duhet të fillojë.

Për të ndihmuar procesin e mësimnxënies personale dhe si propozim për t'i përshtatur ato në jetën e përditshme familjare, 135 përshkruesit do të shfaqen në kapitullin vijues.

Të 135 përshkruesit: Si shfaqen kompetencat demokratike

A. VLERAT

1. Vlerësimi i dinjitetit njerëzor dhe të drejtave të njeriut

- 1 Argumenton se të drejtat e njeriut duhet të mbrohen dhe respektohen gjithmonë
- 2 Argumenton se të drejtat specifike të fëmijëve duhet të respektohen dhe mbrohen nga shoqëria
- 3 Mbron pikëpamjen se askush nuk duhet t'i nënshtrohet torturës ose ndëshkimeve ose trajtimeve jonjerëzore ose poshtëruese
- 4 Argumenton që të gjitha institucionet publike duhet të respektojnë, mbrojnë dhe zbatojnë të drejtat e njeriut
- 5 Mbron pikëpamjen se kur njerëzit burgosen, megjithëse u nënshtrohen kufizimeve, kjo nuk do të thotë se ata janë më pak të merituar për respekt dhe dinjitet se kushdo tjetër
- 6 Shpreh pikëpamjen se të gjitha ligjet duhet të jenë në përputhje me normat dhe standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut

2. Vlerësimi i diversitetit kulturor

- 7 Promovon pikëpamjen se duhet të jemi tolerantë ndaj besimeve të ndryshme që mbajnë të tjerët në shoqëri
- 8 Promovon pikëpamjen se njeriu duhet të përpiqet gjithmonë për mirëkuptim të ndërsjellë dhe dialog kuptimplotë midis njerëzve dhe grupeve që perceptohen të jenë "të ndryshëm" nga njëri-tjetri
- 9 Shpreh pikëpamjen se diversiteti kulturor brenda një shoqërie duhet çmuar dhe vlerësuar pozitivisht

- 10 Argumenton që dialogu ndërkulturor duhet të përdoret për të na ndihmuar të njohim identitetet tona të ndryshme dhe përkatësitë kulturore
- 11 Argumenton që dialogu ndërkulturor duhet të përdoret për të zhvilluar respekt dhe kulturë të "jetesës së përbashkët"

3. Vlerësimi i demokracisë, drejtësisë, paanësisë, barazisë dhe sundimit të ligjit

- 12 Argumenton që shkollat duhet t'i mësojnë nxënësit për demokracinë dhe se si të veprojnë si qytetar demokratik
- 13 Shpreh pikëpamjen se të gjithë qytetarët duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë dhe të paanshëm sipas ligjit
- 14 Argumenton që ligjet duhet të aplikohen dhe zbatohen gjithmonë në mënyrë të drejtë
- 15 Argumenton që zgjedhjet demokratike duhet të zhvillohen gjithmonë lirisht dhe drejtësisht, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe legjislacionin kombëtar, dhe pa ndonjë mashtrim
- 16 Shpreh pikëpamjen se, sa herë që një zyrtar publik ushtron pushtet, ai ose ajo nuk duhet ta keqpërdorë atë pushtet dhe të kalojë kufijtë e autoritetit të tyre ligjor
- 17 Shpreh mbështetjen për pikëpamjen se gjykatat e ligjit duhet të jenë të qasshme për të gjithë në mënyrë që njerëzve të mos u mohohet mundësia për të paraqitur një rast në gjykatë sepse është shumë e shtrenjtë, e mundimshme ose e komplikuar për ta bërë këtë
- 18 Shpreh mbështetjen për pikëpamjen se atyre të cilëve u është besuar pushteti legjislativ duhet t'i nënshtrohen ligjit dhe mbikëqyrjes së duhur kushtetuese
- 19 Shpreh pikëpamjen se informacioni mbi politikat publike dhe zbatimin e tyre duhet të vihet në dispozicion të publikut
- 20 Argumenton se duhet të ketë mjete mbrojtëse efektive kundër veprimeve të autoriteteve publike që shkelin të drejtat civile

B. QËNDRIME

4. Hapja ndaj tjetërsisë kulturore

- 21 Tregon interesim për të mësuar rreth besimeve të njerëzve, vlerave, traditave dhe pikëpamjeve të botës
- 22 Shpreh interesim për të udhëtuar në vende të tjera
- 23 Shpreh kuriozitet rreth besimeve dhe interpretimeve të tjera dhe orientimeve dhe përkatësive të tjera kulturore
- 24 Shpreh një vlerësim të mundësisë për të pasur përvoja të kulturave të tjera
- 25 Kërkon dhe mirëpret mundësitë për t'u takuar me njerëz me vlera, zakone dhe sjellje të ndryshme
- 26 Kërkon kontakte me njerëz të tjerë në mënyrë që të mësojë rreth kulturës së tyre

5. Respektimi

- 27 U jep hapësirë të tjerëve për t'u shprehur
- 28 Shpreh respekt për njerëzit e tjerë si qenie njerëzore të barabarta
- 29 Trajton të gjithë njerëzit me respekt, pavarësisht nga prejardhja e tyre kulturore
- 30 Shpreh respekt ndaj njerëzve që janë me një status socio-ekonomik të ndryshëm nga i tij/saj
- 31 Shpreh respekt për dallimet fetare
- 32 Shpreh respekt për njerëzit që mbajnë mendime të ndryshme politike nga i tij/saj

6. Mendësi qytetare

- 33 Shpreh një gatishmëri për të bashkëpunuar dhe punuar me të tjerët
- 34 Bashkëpunon me njerëz të tjerë për kauza të përbashkëta interesi
- 35 Shpreh përkushtimin për të mos qenë spektator kur shkelet dinjiteti dhe të drejtat e të tjerëve
- 36 Diskuton se çfarë mund të bëhet për të ndihmuar ta bëjë komunitetin një vend më të mirë

- 37 Ushtron detyrimet dhe përgjegjësitë e qytetarisë aktive në nivelin lokal, kombëtar ose global
- 38 Merr masa për të qenë të informuar në lidhje me çështjet qytetare

7. Përgjegjësia

- 39 Tregon që ai ose ajo pranon përgjegjësi për veprimet e tij ose të saj
- 40 Nëse ai ose ajo lëndon ndjenjat e dikujt, ai ose ajo kërkon falje
- 41 Dorëzon punën e kërkuar në kohë
- 42 Tregon që ai ose ajo merr përgjegjësi për gabimet e veta
- 43 Në vazhdimësi përmbush zotimet ndaj të tjerëve

8. Vetë-efikasiteti

- 44 Shpreh një besim në aftësinë e tij ose të saj për të kuptuar çështjet
- 45 Shpreh besimin se ai ose ajo mund të kryejë aktivitete që ai ose ajo ka planifikuar
- 46 Shpreh një besim në aftësinë e tij ose të saj për të lëvizur pengesat kur ndjek një qëllim
- 47 Nëse ai ose ajo dëshiron të ndryshojë, ai ose ajo shpreh besim se ai ose ajo mund ta bëjë këtë
- 48 Tregon që ai ose ajo ndihet i/e sigurt në aftësitë e tij ose të saj për të përmbushur sfidat e jetës
- 49 Tregon besim se ai ose ajo di se si të trajtojë situata të paparashikuara për shkak të shkathtësisë së tij/saj

9. Tolerancë e paqartësisë

- 50 Angazhohet mirë me njerëz të tjerë që kanë një larmi pikëpamjesh të ndryshme
- 51 Tregon që ai ose ajo mund të pezullojë gjykimet për njerëzit e tjerë për kohësisht
- 52 Është rehat në situata të panjohura
- 53 Merret me pasigurinë në një mënyrë pozitive dhe konstruktive
- 54 Punon mirë në rrethana të paparashikueshme
- 55 Shpreh dëshirë për të sfiduar idetë dhe vlerat e tij ose të saj
- 56 I gëzohet sfidës së trajtimit të problemeve të paqarta
- 57 Shpreh kënaqësinë e trajtimit të situatave të ndërlikuara

C. SHKATHËSITË

10. Shkathtësitë e mësimnxënies autonome

- 58 Tregon aftësinë për të identifikuar burimet për mësimnxënie (p.sh. njerëzit, librat, interneti)
- 59 Kërkon sqarim të informacionit të ri nga njerëzit e tjerë kur është e nevojshme
- 60 Mund të mësojë rreth temave të reja me mbikëqyrje minimale
- 61 Mund të vlerësojë cilësinë e punës së vet atij/asaj
- 62 Mund të zgjedhë burimet më të besueshme të informacionit ose këshillës nga diapazoni në dispozicion
- 63 Tregon aftësinë për të monitoruar, përcaktuar, prioritetizuar dhe kompletuar detyrat pa mbikëqyrje të drejtpërdrejtë

11. Shkathtësitë e të menduarit analitik dhe kritik

- 64 Mund të identifikojë ngjashmëritë dhe diferencat midis informacionit të ri dhe atij që dihet tashmë
- 65 Përdor prova për të mbështetur mendimet e tij ose të saj
- 66 Mund të vlerësojë rreziqet që lidhen me opsione të ndryshme
- 67 Tregon se ai ose ajo mendon nëse informacioni që ai ose ajo përdor është i saktë
- 68 Mund të identifikojë ndonjë mospërputhje ose joksistencë ose divergjencë në materialet që analizohen

69 Mund të përdorë kritere, parime ose vlera të qarta dhe specifike për të bërë gjykime

12. Shkathësitë e të dëgjuarit dhe vëzhguarit

70 Dëgjon me kujdes mendime të ndryshme

71 Dëgjon me vëmendje njerëzit e tjerë

72 Shikon gjestet e folësve dhe gjuhën e përgjithshme të trupit për të ndihmuar në gjetjen e kuptimit të asaj që thonë ata

73 Mund të dëgjojë në mënyrë efektive për të deshifruar kuptimet dhe synimet e një personi tjetër

74 I kushton vëmendje asaj që nënkuptojnë njerëzit e tjerë, por nuk thonë

75 Vëren se si njerëzit me përkatësi të tjera kulturore reagojnë në mënyra të ndryshme ndaj së njëjtës situatë

13. Dhembshuria

76 Mund të njohë kur një shoqëruar ka nevojë për ndihmën e tij ose të saj

77 Shpreh simpati për gjërat e këqija që ai ose ajo ka parë të ndodhin tek njerëzit e tjerë

78 Mundohet të kuptojë më mirë miqtë e tij ose të saj duke imagjinuar se si duken gjërat nga këndvështrimi i tyre

79 Merr parasysh ndjenjat e të tjerëve kur merr vendime

80 Shpreh pikëpamjen se, kur ai ose ajo mendon për njerëzit në vendet e tjera, ai ose ajo ndan gëzimet dhe hidhërimet e tyre

81 Identifikon me saktësi ndjenjat e të tjerëve, edhe kur ata nuk duan t'i tregojnë ato

14. Fleksibiliteti dhe përshtatshmëria

82 Modifikon mendimet e tij ose të saj nëse ai ose ajo tregohet përmes argumentit racional se kjo gjë kërkohet

83 Mund të ndryshojë vendimet që ai ose ajo ka marrë nëse pasojat e këtyre vendimeve tregojnë se kjo kërkohet

84 Përshtatet në situata të reja duke përdorur një shkathësi të re

85 Përshtatet në situata të reja duke zbatuar njohuritë në një mënyrë tjetër

86 Miraton konventat sociokulturore të grupeve të tjera kulturore të synuara kur bashkëveprojnë me anëtarët e atyre grupeve

87 Mund të modifikojë sjelljen e tij ose të saj për ta bërë atë të përshtatshme për kulturat e tjera

15. Shkathësi gjuhësore, komunikuese dhe shumëgjuhëshe

88 Mund të shprehë mendimet e tij ose të saj për një problem

89 U kërkon folësve të përsërisin ato që kanë thënë nëse nuk ishte e qartë për ta

90 Bën pyetje që tregojnë të kuptuarit e tij ose të saj për pozitat e njerëzve të tjerë

91 Mund të miratojë mënyra të ndryshme për të shprehur mirësjelljen në një gjuhë tjetër

92 Mund të ndërmjetësojë gjuhësisht në shkëmbimet ndërkulturore duke përkthyer, interpretuar ose shpjeguar

93 Mund të shmangë ose zgjidhë keqkuptimet ndërkulturore

16. Shkathësitë e bashkëpunimit

94 Ndërton marrëdhënie pozitive me njerëzit e tjerë në një grup

95 Kur punon si anëtar i një grupi, bën pjesën e tij ose të saj në punën e grupit

96 Punon për të ndërtuar konsensusin për të arritur qëllimet e grupit

97 Kur punon si anëtar i një grupi, i mbani të tjerët të informuar për çdo informacion të rëndësishëm ose të dobishëm

- 98 Gjeneron entuziazëm midis anëtarëve të grupit për përmbushjen e qëllimeve të përbashkëta
- 99 Kur punon me të tjerët, mbështet njerëzit e tjerë pavarësisht nga ndryshimet në këndvështrime

17. Aftësitë për zgjidhjen e konflikteve

- 100 Mund të komunikojë me palët në konflikt në një mënyrë të respektueshme
- 101 Mund të identifikojë mundësi për zgjidhjen e konflikteve
- 102 Mund të ndihmojë të tjerët për të zgjidhur konfliktet duke rritur të kuptuarit e tyre për opsionet në dispozicion
- 103 Mund të inkurajojë palët e përfshira në konflikte që të dëgjojnë në mënyrë aktive njëri-tjetrin dhe të ndajnë çështjet dhe shqetësimet e tyre
- 104 Fillon rregullisht komunikimin për të ndihmuar në zgjidhjen e konflikteve ndërpersonale
- 105 Mund të merret në mënyrë efektive me stresin emocional, ankthin dhe pasigurinë e njerëzve të tjerë në situata që përfshijnë konflikt

D. NJOHURITË DHE TË KUPTUARIT KRITIK

18. Njohuritë dhe të kuptuarit kritik të vetvetes

- 106 Mund të përshkruajë motivimet e tij ose të saj
- 107 Mund të përshkruajë mënyrat në të cilat mendimet dhe emocionet e tij ose të saj ndikojnë në sjelljen e tij ose të saj
- 108 Mund të reflektojë në mënyrë kritike mbi vlerat dhe besimet e tij ose të saj
- 109 Mund të vetë-reflektojë në mënyrë kritike nga një numër perspektivash të ndryshme
- 110 Mund të reflektojë në mënyrë kritike mbi paragjykimet dhe stereotipet e tij ose të saj dhe çfarë fshihet pas tyre
- 111 Mund të reflektojë në mënyrë kritike mbi emocionet dhe ndjenjat e tij ose të saj në një gamë të gjerë situatash

19. Njohja dhe të kuptuarit kritik të gjuhës dhe komunikimit

- 112 Mund të shpjegojë se si toni i zërit, kontakti me sy dhe gjuha e trupit mund të ndihmojnë komunikimin
- 113 Mund të përshkruajë ndikimin dhe efektet shoqërore mbi të tjerët të stileve të ndryshme të komunikimit
- 114 Mund të shpjegojë se si marrëdhëniet shoqërore kodohen ndonjëherë në format gjuhësore që përdoren në biseda (p.sh. në përshëndetje, forma të adresës, përdorim të përbetimeve)
- 115 Mund të shpjegojë se pse njerëzit e përkatësive të tjera kulturore mund të ndjekin konventa të ndryshme komunikuese verbale dhe joverbale të cilat janë kuptimplote nga perspektiva e tyre
- 116 Mund të reflektojë në mënyrë kritike mbi konventat e ndryshme komunikuese që janë përdorur në të paktën një grup tjetër shoqëror ose kulturë

20. Njohja dhe të kuptuarit kritik të botës (përfshirë politikën, ligjin, të drejtat e njeriut, kulturën, kulturat, fetë, historinë, mediat, ekonominë, mjedisin dhe qëndrueshmërinë)

- 117 Mund të shpjegojë kuptimin e koncepteve themelore politike, përfshirë demokracinë, lirinë, shtetësinë, të drejtat dhe përgjegjësitë
- 118 Mund të shpjegojë se pse të gjithë kanë përgjegjësi të respektojnë të drejtat e njeriut të të tjerëve
- 119 Mund të përshkruajë praktikat themelore kulturore (p.sh. Shprehitë e të ngrënit, praktikat e përshëndetjes, mënyrat e adresimit të njerëzve, mirësjelljen) në një kulturë tjetër
- 120 Mund të reflektojë në mënyrë kritike se si pikëpamja e tij ose e saj botërore është vetëm një nga shumë pikëpamjet e botës
- 121 Mund të vlerësojë ndikimin e shoqërisë në botën natyrore, për shembull, në drejtim të rritjes së popullsisë, zhvillimit të popullsisë, konsumit të burimeve
- 122 Mund të reflektojë në mënyrë kritike mbi rreziqet që lidhen me dëmtimin e mjedisit

- 123 Mund të shpjegojë natyrën universale, të patjetërsueshme dhe të pandashme të të drejtave të njeriut
- 124 Mund të reflektojë në mënyrë kritike në marrëdhëniet midis të drejtave të njeriut, demokracisë, paqes dhe sigurisë në një botë të globalizuar
- 125 Mund të reflektojë në mënyrë kritike mbi shkaqet themelore të shkeljeve të të drejtave të njeriut, përfshirë rolin e stereotipeve dhe paragjytimeve në proceset që çojnë në abuzime të të drejtave të njeriut
- 126 Mund të shpjegojë rreziqet e përgjithësimit nga sjelljet individuale në një kulturë të tërë
- 127 Mund të reflektojë në mënyrë kritike mbi simbolet fetare, rritualet fetare dhe përdorimet fetare të gjuhës
- 128 Mund të përshkruajë efektet që ka propaganda në botën bashkëkohore
- 129 Mund të shpjegojë se si njerëzit mund të ruhen dhe mbrohen nga propaganda
- 130 Mund të përshkruajë mënyra të ndryshme në të cilat qytetarët mund të ndikojnë në politikë
- 131 Mund të reflektojë në mënyrë kritike mbi natyrën në zhvillim të kornizës së të drejtave të njeriut dhe zhvillimin e vazhdueshëm të të drejtave të njeriut në rajone të ndryshme të botës
- 132 Mund të shpjegojë se pse nuk ka grupe kulturore që kanë karakteristika të fiksuara të qenësishme
- 133 Mund të shpjegojë se pse të gjitha grupet fetare vazhdimisht evoluojnë dhe ndryshojnë
- 134 Mund të reflektojë në mënyrë kritike se si historitë shpesh paraqiten dhe mësohen nga një këndvështrim etnocentrik
- 135 Mund të shpjegojë ekonominë kombëtare dhe si ndikojnë proceset ekonomike dhe financiare në funksionimin e shoqërisë

SI TË PËRDORNI MODELIN E KOMPETENCËS

Për vetë-reflektim të mësimdhënësit

Të jesh një “mësimdhënës demokrat” kërkon më shumë sesa të jesh i mirë në lëndën tuaj. Kjo kërkon, të përmendim vetëm disa, aftësinë për të dëgjuar nxënësit, kolegët dhe prindërit, hapjen për përkatësitë kulturore dhe praktikë që ato sjellin në procesin arsimor dhe ndjeshmërinë, dhe një ndjenjë të përgjegjësisë për mirëqenien dhe fuqizimin e të gjithëve nxënësve. Ky është një nga qëllimet e KKD-së: të ndihmojë mësimdhënësit për t’u bërë më demokrat. Prandaj, është zhvilluar një mjet i vetë-reflektimit të një mësimdhënësi për të mbështetur mësimdhënësit dhe mësimdhënësit të nxënësve në zhvillimin e etosit dhe kompetencave të tyre demokratike profesionale. Këtu mund ta përdorni atë drejtpërdrejt dhe të gjeni mënyrën tuaj në ritmin tuaj të punës: <https://trt.intercultural.ro/>

Qëllimi i këtij mjeti është të shoqërojë mësimdhënësit dhe shumëzuesit në këtë proces dhe në punën e tyre me Kornizën Referencë të Kompetencave për Kulturën Demokratike (KRKKD) të Këshillit të Evropës. Mund të përdoret si nismëtar për t’u njohur me KRKKD por gjithashtu mund të shihet si një shoqërues shumë i përgjithshëm i vetë-reflektimit mbi mësimdhënien dhe kompetencat demokratike. Ky mjet mund t’ju udhëzojë dhe strukturojë udhëtimin tuaj të eksplorimit dhe zhvillimit të rolit dhe praktikës suaj si mësimdhënës, ndërsa ju mundëson të vendosni se sa kohë dhe përpjekje dëshironi të shpenzoni për të.

Pjesët e ndryshme në mjetin e vetë-reflektimit:

- ▶ Zbulimi i modelit të kompetencave për kulturë demokratike
- ▶ Përgatitja: familjarizohuni me vëzhgimin, reflektimin dhe vetë-reflektimin për KKD
- ▶ Modulet: module reflektuese që ndjekin temat e fokusit të projektit të Këshillit të Evropës “Të lirë të flasim, të sigurt të mësojmë - Shkolla demokratike për të gjithë”. Modulet mund të bëhen në çfarëdo renditje; secili modul është një njësi e veçantë, e pavarur.

Disa pika të mundshme të hyrjes dhe mënyrat e përdorimit të mjetit të vetë-reflektimit:

▶ Ju jeni të njohur me KRKKD-në:

=> Mund të filloni me reflektime personale në pjesën e Përgatitjes ose të zgjidhni drejtpërdrejt një modul tematik që ju intereson.

▶ Ju jeni disi të njohur me KRKKD-në por nuk jeni i sigurt për disa aspekte:

=> Ju mund të merrni kuizin. Nëse merrni një rezultat të përsosur, mund të bëni siç tregohet më sipër. Nëse jo, ju mund të dëshironi të lexoni KRKKD-në shkurtimisht dhe pastaj të merrni përsëri kuizin

▶ Tani po zbuloni KRKKD-në:

=> varësisht nga mënyra juaj e preferuar e mësimnxënies dhe e punës mund të zgjidhni një nga opsionet e përshkruara më poshtë (por gjithashtu mund të krijoni një shteg përmes mjetit në mënyrën tuaj)

Nëse dikush preferon që konceptet të jenë të qarta fillimisht, ata mund të fillojnë me leximin e KRKKD-së, pastaj të marrin kuizin dhe pastaj të kalojnë në pjesët e tjera

Nëse dikush preferon të bëjë diçka, eksplorojë diçka praktike dhe merrni sqarime konceptuale vetëm kur dhe nëse është e nevojshme, atëherë ai/ajo zgjedh ndonjë modul tematik dhe, kur ata identifikojnë nevojën, ata shkojnë në KRKKD shkurtimisht dhe sqarojnë konceptet përkatëse

Nëse dikush preferon të reflektojë së pari mbi veten e tij dhe pastaj të mendojë për konceptet dhe/ose praktikën, ata fillojnë me seksionin e përgatitjes.

Modeli i kompetencës për planifikim

Mësimdhënësit mund të organizojnë një shumëllojshmëri të gjerë të qasjeve pedagogjike që janë të përshatshme për zhvillimin e KKD-së dhe kështu të ndihmojnë në krijimin e mjediseve më të këndshme dhe të sigurta të mësimnxënies ndërsa adresojnë strukturat e dhunshme, diskriminuese dhe anti-demokratike brenda mjediseve të klasës. Përmes planifikimit, ndjekjes së zhvillimit të KKD-së midis nxënësve dhe vlerësimit të aktiviteteve të tyre, mësimdhënësit si lehtësues të mësimi do të përqendrohen në parimet e Kornizës dhe të miratojnë qasje dhe metoda pedagogjike që inkurajojnë nxënësit të përfshihen aktivisht në përvojën,

zbulimin, sfidën, analizën, krahasimin, reflektimin dhe bashkëpunimin. Ata rishikojnë rolin e tyre në klasë për të adresuar më mirë nxënësit si persona të tërë dhe për të angazhuar fëmijët me kokën, zemrën dhe duart e tyre dhe të zhvillojnë praktika që janë më të përshtatshme për zhvillimin e autonomisë dhe përgjegjësisë së nxënësve në çështjet e kompetencës për një kulturë demokratike.

Për t'iu përgjigjur një pyetjeje të dëgjuar shpesh që në fillim: Zhvillimi i KKD-së mund të kuptohet në mënyrë të qartë, si temë dhe në mënyrë të nënkuptuar, si shqetësim transversal i integruar në proceset e përgjithshme të mësimdhënies dhe mësimnxënies që ndodhin në shkolla brenda një kornize të përgjegjësisë së përbashkët. Qasjet pedagogjike të integruara në KKD dhe të përshkruara më poshtë janë, siç do ta dinë edukatorët me përvojë, jo vetëm të përshtatshme për zhvillimin e KKD-së, por ato gjithashtu ndihmojnë në krijimin e mjediseve më të këndshme dhe të sigurta të mësimnxënies dhe gjetjen e mënyrave për të adresuar struktura të dhunshme, diskriminuese dhe anti-demokratike brenda mjediseve shkollore.

Si të organizohet procesi i mësimnxënies

Pyetjet e mëposhtme mund të drejtojnë reflektimin se si të organizohen proceset mësimore:

Deri në çfarë mase do të thonit që mësimdhënia juaj kontribuon që nxënësit të bëhen qytetarë aktivë/ duke respektuar të drejtat e njeriut?
Sa shpesh nxënësit tuaj kanë mundësi të shprehin idetë e tyre/të dëgjojnë pikëpamje të ndryshme, të diskutojnë ndryshimet e tyre në klasë?
Sa shpesh shtrohen pyetjet në lidhje me të drejtat e njeriut, qytetarinë demokratike, drejtësinë, barazinë ose sundimin e ligjit në klasat që ju jepni mësim?
Si po e lehtëson praktika juaj e tanishme zhvillimin e burimeve intelektuale, personale dhe shoqërore që do t'u mundësojë nxënësve të marrin pjesë si qytetarë aktivë?
Si po u siguron kohë nxënësve të punojnë me njëri-tjetrin për të forcuar të kuptuarit e tyre, si dhe të praktikojnë shkathtësitë shoqërore, duke nxitur kështu si proceset individuale ashtu edhe ato shoqërore dhe rezultatet përfundimtare?
Sa shpesh jeni duke përfshirë aktivitete praktike dhe qasje eksperimentale?
A e praktikoni në mënyrë efektive përvojën e mëparshme të nxënësve në mësimdhënien tuaj?

Parimet e planifikimit

Planifikimi dhe ndjekja e zhvillimit të KKD-së midis nxënësve është i rëndësishëm për të gjithë lehtësuesit e mësimnxënies. Të qenit i vetëdijshëm për disa do të ndihmojë mësimdhënësit, si lehtësues të përfshijnë mundësi për:

Përvoja. Një mënyrë e përshtatshme për zhvillimin e qëndrimeve të respektit dhe hapjes, si dhe ndjeshmërisë, është duke siguruar mundësi për të mësuar përmes përvojës, të cilat mund të jenë reale ose të imagjinuara; nxënësit janë në gjendje t'i përjetojnë këto qëndrime përmes, për shembull, lojërave, aktiviteteve, mediave tradicionale dhe mediave sociale, ndërveprimit ballë për ballë me të tjerët ose përmes korrespondencës.
Krahasimi. Nxënësit mund të përfitojnë nga ekspozimi ndaj "diferencës". Nxënësit shpesh krahasojnë atë që është e panjohur me atë që është e njohur dhe e vlerësojnë të panjohurën si "të çuditshme", si "më keq" apo edhe si "të paqytetëruar". Mësuesit duhet të jenë të vetëdijshëm për këtë lloj krahasimi të vlerës dhe ta zëvendësojnë atë me krahasimin për të kuptuarit, që përfshin shikimin e ngjashmërive dhe diferencave në një mënyrë jo-gjyquese dhe marrjen e perspektivës së tjetrit. Nxënësit reflektojnë dhe angazhohen në një krahasim të vetëdijshëm të vlerave dhe qëndrimeve të tyre me ato të ndryshme, në mënyrë që të vetëdijohen se si e ndërtojnë ata realitetin.

Analizimi. Pas ngjashmërive dhe diferencave ka shpjegime për praktika, mendime, vlera dhe besime. Lehtësuesit mund të mbështesin nxënësit e tyre në analizën e asaj që mund të qëndrojë nën atë që ata mund të shohin të tjerët duke bërë dhe thënë. Kjo mund të arrihet, për shembull, me diskutim dhe analizë të kujdesshme, përmes metodave të bazuara në kërkime, të burimeve të shkruara ose audio/video.

Reflektimi. Krahasimi, analizimi dhe përvoja duhet të shoqërohen nga koha dhe hapësira për reflektim dhe zhvillim të vetëdijesimit dhe të kuptuarit kritik. Lehtësuesit, veçanërisht në arsimin joformal dhe formal, duhet të sigurojnë që koha dhe hapësira e tillë të sigurohet në një mënyrë të qëllimshme dhe të planifikuar.

Veprimi. Reflektimi mund dhe duhet të jetë baza për ndërmarrjen e veprimeve, për angazhimin me të tjerët përmes dialogut dhe për t'u përfshirë në aktivitete bashkëpunuese me të tjerët. Lehtësuesit mund të marrin përgjegjësinë e inkurajimit dhe madje edhe të menaxhimit të veprimeve bashkëpunuese, për shembull në bërjen e përmirësimeve në mjedisin social dhe fizik përmes qasjeve që përfshijnë "tërë shkollën" ose partneriteteve shkollore.

3.3. Modeli i kompetencës për vlerësimin e mësimdhënies

Vëzhgoni kulturën demokratike në klasë përmes kompetencave dhe përshkruesve që përputhen

- ▶ Kuptoni të gjitha 20 kompetencat dhe 135 përshkruesit
- ▶ Analizoni klasën duke përdorur kompetencat dhe përshkruesit: cilat përdoren, tregohen, trajnohen?
- ▶ Mundohuni të shikoni kohën midis orëve, pushimeve, diskutimeve anësore. Cilat kompetenca dhe përshkrues janë të dukshme?
- ▶ Plotësoni listën me kompetencat që keni vërejtur dhe shënoni kur secila ishte e dukshme gjatë orës së mësimt.

Kompetenca dhe përshkruesit që përputhen të parë (zgjidhni nga 20 kompetencat e 'fluturës'). Kompetencat nuk izoloohen asnjëherë. Ata vijnë në grupe!	Situata e mësimnxënies gjatë së cilës janë aplikuar ose trajnuar kompetencat/përshkruesit.

PJESA C:
NJË FORMË E RËNDË E
PËRJASHTIMIT TË PËRDITSHËM:
BULLIZMI



HYRJE: BULLIZMI - NJË TEMË E RËNDËSISHME KUDO

Bullizmi nuk është fenomen i ri. Ai është i përhapur në shumë shkolla, megjithëse nuk duhet ngatërruar me konflikte jetëshkurtra, debate, konfrontime agresive ose përjashtime midis fëmijëve dhe të rriturve. Bullizmi mund të ndikojë në një sërë situatash të tilla si:

- ▶ Mësimdhënësi flet me nënçmim për një nxënëse para klasës sepse ajo nuk ka vëmendja ose është gjithmonë e sëmurë.
- ▶ Ose shokët e klasës pëshpëritin, qeshin nën hundë ose hedhin vërejtje fyese kur një nxënës i caktuar flet.
- ▶ Ka vajza në një klasë të 7-të që ngacmojnë një shoqe klase të huaj për shkak të pamjes së saj dhe gjuhës së keqe.
- ▶ Djemtë e një klase së katërt e presin një nxënës shok të ndrojtur, disi të dobët, gjatë rrugës për në shkollë dhe i zhvatin para ose rroba.
- ▶ Është një nënë që ndiqet në mbledhjet e prindërve me vështrime tallëse nga prindërit e tjerë dhe mësimdhënësi.
- ▶ Kolegët në hapësirën e personelit largohen dhe ndalojnë së foluri kur hyn një koleg i caktuar.

Shpesh të rriturit nuk janë në dijeni ose shikojnë nga ana tjetër, ndërsa viktimat, qofshin fëmijë apo të rritur, fajësojnë vetveten dhe gjithnjë e më shumë izoloohen shoqërisht. Mësimdhënësit zakonisht befasohen kur iu informohen për bullizmin në një klasë. Kjo sepse bullizmi shpesh ndodh shumë me delikatesë dhe kryesisht jashtë klasës, gjatë pushimeve ose gjatë rrugës për në shkollë.

Sa më gjatë të vazhdojë bullizmi, aq më e vështirë është të gjesh një zgjidhje dhe aq më e sigurt është që fëmijët ose të rriturit në fjalë do të preken fizikisht ose emocionalisht. Ajo që duhet përmendur gjithashtu këtu është një formë shumë specifike e përjashtimit dhe mobingut, e cila diskutohet gjithnjë e më shumë nën termin antigjipizëm. Antigjipizmi është racizmi specifik ndaj romëve, sinti, udhëtarëve dhe të tjerëve që stigmatizohen si 'ciganë' në imagjinatën e publikut. Megjithëse termi po gjen njohje në rritje institucionale, ende nuk ka kuptim të përbashkët për natyrën dhe pasojat e tij. Antigjipizmi përdoret shpesh në një kuptim të ngushtë për të treguar qëndrimet anti-rome ose shprehjen e stereotipeve negative në sferën publike në shkolla ose përmes gjuhës së urrejtjes. Sidoqoftë, antigjipizmi krijon një spektër shumë më të gjerë të shprehjeve dhe praktikave diskriminuese, duke përfshirë shumë manifestime të nënkuptuara ose të fshehura. Antigjipizmi nuk ka të bëjë vetëm me ato që thuhet, por edhe me ato që bëhen dhe ato që nuk bëhen.

Në kapitujt e shkurtër të mëposhtëm, së pari paraqitet informacioni më i rëndësishëm i historikut. Kjo pasohet nga tregues të shkurtër dhe të qartë të kurseve të mundshme të veprimit. Në fillim, megjithatë, një fenomen i rëndësishëm nuk duhet të fshihet. Po sikur të mos jenë shokët e klasës, por mësimdhënësi që është autori i bullizmit?

DHE ÇFARË KUR MËSIMDHËNËSI ËSHTË BULLIST?

Pas heqjes së ndëshkimit trupor, mësimdhënësit ende përdorin dhunë ndaj nxënësve në shkolla. Metodatat janë bërë më delikate: Sulmet verbale, cinizmi, fyerjet dhe shpifjet shërbejnë si zëvendësues të kallamit. Dhuna e mësimdhënësve është një temë tabu. Politikanët, mësimdhënësit dhe prindërit heshtin për këtë çështje. Kjo është e gabuar! Nxënësit që nuk kanë askënd për t'iu ndihmuar janë lojë fer për mësimdhënësit bullistë.

Asnjë mësimdhënësi nuk shkon në shkollë në mëngjes me qëllimin e vendosur të torturojë nxënësit. Vetëm disa bindës mbështesin dhunën në klasë. Mësimdhënësit janë nën presion të madh në shkollë dhe shpesh ndihen të mbingarkuar. Kur nxënësit janë shumë të padisiplinuar, shumë prej tyre nuk dinë si ta ndihmojnë veten dhe t'i kapin nxënësit. A janë mësimdhënësit, pra, viktimat e vërteta të sistemit shkollor? Jo! Ata kanë zgjedhur lirshëm profesionin e tyre dhe mund të mbrojnë interesat e tyre si qytetarë të përgjegjshëm. Nga ana tjetër, fëmijët duhet të shkojnë në shkollë. Ata janë në mëshirën e mësimdhënësve të tyre.

Dhuna në klasë ka shumë fytyra: mësimdhënësit injorojnë mundimin dhe qëndrojnë joaktiv edhe kur kockat thyhen dhe plagët rrjedhin gjak. Disa mësimdhënësit i zgjedhin nxënësit për muaj të tërë, duke i ekspozuar ata qëllimisht në tallje nga shokët e tyre të klasës. Ndonjëherë mësimdhënësit kthehen në modelet e lashta të goditjes me kokë në kokë dhe shkelmimit të prapanicës, duke i detyruar të qëndrojnë në qoshe për orë të tëra, ose duke ndaluar nxënësit të shkojnë në tualet derisa të lagen.

3. Mësimdhënësi ose nxënësit vizatojnë kërcellin dhe gjethet e secilës lule për të krijuar një buqetë. Bashkimi i një fjongoje e bën buqetën të duket shumë e veçantë!

Zgjerimi

Të ulur në një rreth, nxënësit japin komentet e tyre. Kjo u ndihmon nxënësve të kuptojnë kuptimin simbolik: buqeta do të humbte bukurinë e saj nëse disa lule do të mungonin (komuniteti); secila lule është e ndryshme dhe shton diçka unike (dinjiteti i personit); në të njëjtën kohë, të gjitha lulet janë të ngjashme dhe prandaj njëra është po aq e rëndësishme sa tjetra (barazia). Konceptet në kllapa mund të përfshihen në klasat me nxënësit më të vjetër.

Shkopinj kinezë

Objektivat arsimore	Nxënësit trajnohen në shkathtësitë e lojtarëve të ekipit. Ata përjetojnë atë që do të thotë të varet nga të tjerët, dhe të tjerët duhet të varen nga ata (ndërvarësia).
Burimet	Shkopinj kinezë ose lapsa, stilolapsa, etj. (rreth 15 cm të gjatë).

Procedura:

1. Klasa ndahet në grupe me rreth tetë nxënës. Grupeve u thuhet se duhet të përshkojnë një distancë të caktuar (nëse është e mundur, ushtrimi duhet të bëhet jashtë objektit të shkollës).
2. Grupet qëndrojnë në rreshta, me një distancë prej rreth 1 - 1.5 metra midis tyre.

- Nxënësit marrin shkopinjë të tyre kinezë (ose stilolapsat, lapsat) midis majave të gishtërinjve tregues. Shkopinjë tani i lidhin nxënësit së bashku.
- Tani grupet duhet të garojnë drejt një qëllimi që është vendosur më parë, për shembull klasa ose skaji tjetër i oborrit të shkollës. Nëse dy nxënës e lëshojnë shkopin e tyre, i gjithë ekipi duhet të kthehet në pikën e fillimit dhe të fillojë përsëri nga atje. Ekipet janë të lira të zhvillojnë teknikën dhe strategjinë më të mirë për të lëvizur me shpejtësi drejt qëllimit pa i lëshuar shkopinjët.

Në varësi të asaj se sa e vështirë rezulton se është detyra për nxënësit, këto rregulla mund të zbatohen pak a shumë në mënyrë rigorozë ose të përshtaten për nevojat specifike të aftësive të kufizuara.

Zgjerimi:

- ▶ Disa nxënës mund të veprojnë si vëzhgues të jashtëm të cilët mund të komentojnë për mënyrën e bashkëpunimit të grupeve me njëri-tjetrin.
- ▶ Aktivitetet mund të filmohen për të treguar forma të ndryshme të sjelljes.

QARTËSIMI I VLERAVE

Gjithëpërfshirja është një qëndrim. Një qëndrim nga i cili lindin veprimet. Disa vlera përcaktojnë qëndrimin e gjithëpërfshirjes. Praktikimi i vlerave nuk mund të jetë gjithmonë i lehtë.

Sepse qëndrimet dhe veprimet gjithëpërfshirëse janë radikale: ato shkojnë në rrënjë. Ato shkojnë në rrënjët e të kuptuarit tonë për njerëzimin, në rrënjët e konceptimit tonë për njerëzimin. Për mësimdhënësit, përfshirja nënkupton përkthimin e vlerave të caktuara në veprim në arsimin e përditshëm. Është një angazhim ndaj vlerave të caktuara që krijon një dëshirë për të kapërcyer përjashtimin dhe për të promovuar gjithëpërfshirjen. Nëse gjithëpërfshirja nuk është e lidhur me vlerat në të cilat dikush beson thellësisht, atëherë ndjekja e përfshirjes mund të jetë thjesht një përshtatje e një mënyre kaluese, ose një pajtueshmëri e hapur me direktivat e qeverisë nacionale ose lokale, pushtetit lokal. Planet e mëposhtme tregojnë se si arsimimi për vlerat mund të zbatohet në terma realë.

Loja e trapeve

Objektivat arsimore	Nxënësit njihen me nocionin e vlerave dhe mësojnë se si të identifikojnë paragjykimet.
Burimet	Kartat që japin informacion në lidhje me personazhet.

Procedura:

Nëntë njerëz janë larg nga një trap në det të hapur. Ata nuk e dinë pozitën e tyre të saktë. Trapi është shumë i vogël për të gjithë ata. Katër prej tyre duhet të hidhen në det.

Kush do të jenë ata dhe pse?

Secili nxënës merr një kartë që jep disa informacione në lidhje me karakterin që ajo ose ai duhet të përfaqësojë.

Kjo nuk është vetëm një lojë me role por edhe një çështje e identifikimit me një personazh duke gjetur arsye se përse ai ose ajo meriton të mbijetojë më shumë sesa të tjerët. Ata gjithmonë duhet të përdorin vetën e parë - "Unë". Situata dhe ajo që është në rrezik tregohet gjithashtu në kartë. Duhet të ketë heshtje të plotë gjatë kësaj faze të parë dhjetë minutëshe.

- Nxënësit punojnë në grupe me nga gjashtë veta.
 - Secili grup vendos se kush duhet të shpëtohet sipas argumenteve të paraqitura nga secili nxënës. Për të rritur ndërveprimin, secili person jo vetëm që duhet të mbrojë karakterin e tij ose të saj, por gjithashtu duhet të sulmojë një tjetër. Sidoqoftë, një vendim kolektiv duhet të arrihet brenda njëzet minutash.
- Secili grup raporton zgjedhjet e tij dhe krahason me grupet e tjera.
- E gjithë klasa identifikon vlerat dhe paragjykimet që janë paraqitur.

Materialet:

Disa shembuj të personazheve të ndryshëm

Një dekorues 35-vjeçar, beqar, i cili është aktiv në një lëvizje politike.	Një rom që sapo ka dalë nga burgu.
Një prostitutë me HIV pozitiv.	Një grua e moshuar, një e ve, e cila po udhëton në vendin e saj të lindjes me kursimet e saj në mënyrë që të shohë përsëri djalin e saj.
Një pianist rus, baba i dy fëmijëve.	Një kokërruar (skinhead) anglez që është i dehur.
Një adoleshent 15-vjeçar, fitues i një çmimi të rëndësishëm letërsie.	Një lojtar i vjetër i famshëm amerikan i bejsbollit.
Një ambasador që punon për Organizatën e Kombeve të Bashkuara.	Një nënë e re që ka një këmbë të thyer.
Një ushtar duke u kthyer nga detyra jashtë vendit.	

Sistemet e vlerave

Objektivat arsimore	Nxënësit zbulojnë se vlera të ndryshme janë një burim i mundshëm konflikti.
Burimet	Letër dhe lapsa, një tabelë që përmban një listë të vlerave të ndryshme.

Procedura:

Çdo nxënës i jepet një listë me 20 vlera, jo në ndonjë mënyrë të veçantë: sukcesi shoqëror, dashuria, bindja, siguria, paqja, rendi, dinjiteti njerëzor, rahatia personale, barazia, respekti për të tjerët, ndershmëria, familja, solidariteti, përgjegjësia, drejtësia, toleranca, liria, konkurrenca, shëndeti, patriotizmi.

1. Nxënësit punojnë në çifte.
2. Mësimdhënësi kërkon që nxënësit të grupojnë vlerat në listë në tri kategori. "Në të parën, vendosni ato që ju duken më të rëndësishme; në të dytën, më pak të rëndësishmet; dhe të fundit ato që janë të paklasifikueshme".
Kjo punë duhet të bëhet ngadalë dhe me mendim.
3. Informatat kthyesë zhvillohet në grupe çiftesh alternative, përmes diskutimit.
Asnjë hierarki nuk është e preferueshme për një tjetër. Asnjë vlerësim ose notë nuk do të jepet për aktivitetin.
Mësimdhënësi duhet të theksojë diferencën midis vlerave të thjeshta ideale dhe vlerave efektive - ato që marrin parasysh një lloj sjelljeje.
4. Kërkojuni nxënësve të mbajnë listën e tyre me zgjedhjet e tyre të para.

Materiallet:

Lista e vlerave

sukses shoqëror	dashuri	bindje
siguri	paqe	rend
dinjitet njerëzor	rehati personale	barazi
respekt për të tjerët	ndershmëri	familje
solidaritet	përgjegjësi	drejtësi
tolerancë	liri	konkurrencë
shëndet	patriotizëm	

NJOHJA ME TË DREJTAT E NJERIUT

Gjithëpërfshirja nuk është vetëm një ide e mirë, por, siç u përmend disa herë, e drejtë e njeriut. Gjithëpërfshirja do të thotë që asnjë qenie njerëzore nuk mund të përjashtohet, marginalizohet ose përjashtohet nga shoqëria. Si e drejtë e njeriut, gjithëpërfshirja është e lidhur drejtpërdrejt me të drejtat e lirisë, barazisë dhe solidaritetit. Kështu që, gjithëpërfshirja është një e drejtë më vete dhe një parim i rëndësishëm pa zbatimin e të cilit zbatimi i të drejtave të njeriut mbetet i paplotë. Planet mësimore në vijim tregohen me shembull, se si mund të bëhet kjo në një mënyrë të lehtë.

Posteri i të drejtave të njeriut

Objektivat arsimore	Nxënësit kuptojnë aspektet e mëposhtme të të drejtave të njeriut: strukturën e tyre themelore (kush gëzon të drejtë njerëzore - përmbajtjen - mënyrën e zbatimit); problemin e shkeljes së të drejtave të njeriut; mjetet e mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Nxënësit praktikojnë shkathtësitë e tyre të leximit dhe zhvillojnë shkathtësitë e tyre krijuese.
Burimet	Fletë të mëdha, letër me madhësi A4 në ngjyra të ndryshme, lapsa, gërshërë, ngjitës, revista dhe gazeta të vjetra, piktura dhe fotografi; teksti i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut ose Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut (kopjuar nga interneti)

Procedura:

1. Nxënësit formojnë grupe me nga katër veta.
2. Mësimdhënësi cakton një artikull që përfaqëson një të drejtë njerëzore për secilin grup. Nxënësit më të moshuar mund të vendosin se me cilin artikull dëshirojnë të merren dhe të shpjegojnë zgjedhjen e tyre (shih hapin 4).
3. Secili grup përgatit një poster për të drejtën e njeriut. Posteri përbëhet nga pjesët e mëposhtme:
 - a. titulli që i jep të drejtën e njeriut;
 - b. teksti nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut ose Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut;
 - c. një fotografi që simbolizon të drejtën e njeriut (p.sh. një veturë mund të simbolizojë lirinë e lëvizjes ose një portë e mbyllur mund të simbolizojë jetën private);
 - d. një analizë e strukturës së të drejtës së njeriut (për klasa të avancuara), duke iu referuar:

- personave që gëzojnë këtë të drejtë;
- përmbajtjes (çfarë mbron apo jep e drejta);
- mjetet e zbatimit;
- e. një simbol (p.sh. një rrotë për lirinë e lëvizjes ose buzët për lirinë e shprehjes).

4. Grupet prezantojnë dhe diskutojnë posterat e tyre në klasë.

Zgjerimi

Posterit gjithashtu mund të përmbajë shembuj të shkeljeve të së drejtës së njeriut në fjalë dhe si mund, ose duhet, të zbatohet.

Spangot

Objektivat arsimore	<p>Qëllimi i këtij ushtrimi është të paraqesë një perspektivë globale të origjinës sonë të përbashkët dhe shtëpisë së përbashkët si hyrje në edukimin për të drejtat e njeriut.</p> <p>Të gjithë njerëzit kanë të njëjtën origjinë, të njëjtën tokë dhe ata kanë të njëjtat të drejta, pavarësisht se ku jetojnë ose në çfarë situatë. Ky ushtrim vizualizon figura të mëdha për t'i bërë ato më të kuptueshme për fëmijët.</p>
Burimet	Dy copa spangosh, 4.8 dhe 6.7 metra të gjatë, mundësisht një hartë e botës ose një glob.

Procedura:

1. Mësimdhënësi u tregon nxënësve spangon 4.8 metra dhe u kërkon të gjejnë se sa e gjatë është. Kur nxënësit bien dakord që është 4.8 metra e gjatë, ai i pyet se sa milimetra është kjo.
2. 4 800 milimetra mund të simbolizojnë historinë e tokës sonë, pasi supozohet të jetë e vjetër 4 800 milion vjet.
3. Mësimdhënësi kthehet në krijimin e planetit dhe kalon nëpër ngjarjet kryesore të historisë së tokës, 1 milimetër duke qenë 1 milion vjet. Sa kohë kanë qenë qeniet njerëzore në këtë tokë? Ai u tregon 1-2 milimetrat e fundit dhe e krahason me pjesën tjetër të spangos. Mbase qeniet njerëzore nuk janë aq të rëndësishme? Ndoshta duhet të jemi shumë të kujdesshëm për t'u kujdesur për planetin në të cilin jetojmë?
4. Mësimdhënësi u tregon nxënësve pak mbi historinë e njeriut. Me sa dimë qeniet njerëzore e kanë origjinën në Afrikë. Në fillim, të gjithë ishim afrikanë! Pastaj njeriu migroi nga Afrika dhe përfundimisht populloi tërë tokën. Sot ne jemi shumë vende dhe shumë grupe të ndryshme, që flasim shumë gjuhë të ndryshme dhe kemi fe dhe kultura të ndryshme, por fillimisht ishim të gjithë njësoj.
5. Mësimdhënësi u tregon nxënësve spangon e dytë. Sa e gjatë është? Sot ne jemi 6.7 miliardë njerëz në tokë.⁴ Kështu 1 milimetër në spango korrespondon me 1 milion njerëz. Ai u tregon madhësinë e disa prej vendeve më të mëdha në spango. Sa është madhësia e vendit tonë? Disa njerëz duket se e ndajnë botën në «njerëzit tanë» dhe «të huaj». Spango na tregon se shumica e njerëzve janë «të huaj»! Por ne të gjithë e ndajmë këtë planet si shtëpinë tonë dhe duhet të mësojmë se si të jetojmë së bashku në të. Vendet e botës, përmes Organizatës së Kombeve të Bashkuara, kanë vendosur që edhe nëse jemi të ndryshëm dhe jetojmë në vende të ndryshme, të gjithë kemi të njëjtat të drejta.

Pema e të drejtave të njeriut

Objektivat arsimore	Nxënësit zhvillojnë një kornizë konceptuale për të gjykuar të drejtat e njeriut.
Burimet	Lapsat me ngjyra, fletë të mëdha letre për t'u vendosur në mur.

Procedura:

1. Mësimdhënësi i ndan nxënësit në grupe të vogla prej tre deri në pesë veta.
2. Ai u kërkon atyre të vizatojnë një pemë të këndshme dhe ta quajnë "pema e të drejtave tona të njeriut". Pranë fundit të pemës ata duhet të shkruajnë "të drejtat e njeriut".
3. Atëherë pema duhet të ketë disa degë kryesore me disa nga konceptet kryesore që nxënësit mendojnë se janë ose duhet të përfshihen në të drejtat e njeriut. Rreth këtyre degëve kryesore mund të ketë një numër degësh më të vogla me gjëra që ata mendojnë se janë të lidhura me ato kryesore.
4. Pas një kohe të caktuar, grupet vendosin vizatimin e tyre në mur dhe u shpjegojnë të tjerëve se çfarë kanë shkruar në të. Këta postera mund të lihen në mur për ca kohë. Ata do të shërbejnë si zbulime dhe mund të përdoren përsëri gjatë mësimeve të mëvonshme.

Zgjerimi

Pasi të keni mësuar në lidhje me idetë e nxënësve për të drejtat e njeriut, mund të vazhdoni të mësoni të drejtat e njeriut ose të drejtat e fëmijëve në më shumë detaje dhe të zbuloni se në çfarë mase korrespondojnë të drejtat aktuale me ato që kanë shkruar nxënësit.

Udhëtimi me balonë

Objektivat arsimore	Nxënësit vetëdijesohen për vlerat universale në të drejtat e njeriut. Ata e kuptojnë që disa të drejta të njeriut në mënyrë implicite gjenden brenda të tjerave, por, brenda sistemit të të drejtave të njeriut, bën një ndryshim nëse mbrohen apo jo të drejtat specifike të njeriut. Nxënësit e kuptojnë që të drejtat e njeriut janë të patjetërsueshme dhe se heqja arbitrare e të drejtave të njeriut kufizohet në diktaturë.
Burimet	Lapsa dhe letër, mundësisht fletë të mëdha për t'u vendosur në mur; listë e të drejtave për t'u hedhur me prioritet.

Procedura

1. Mësimdhënësi e menaxhon lojën. Nxënësit formojnë grupe me nga pesë deri në gjashtë persona. Secili grup merr një poster dhe lapsa markerësh. Nxënësit vizatojnë një balonë me ajër të nxehtë mbi oqean ose peizazhin lokal. Thasët me zhavorr që simbolizojnë dhjetë të drejtat e njeriut janë ngjitur në poster (shih listën më poshtë).
2. Tani loja fillon. Nxënësit duhet ta imagjinojnë veten duke udhëtuar me "balonën e të drejtave të njeriut". Balona fillon të ulet dhe pasagjerët duhet të heqin disa thasë me zhavorr për të shmangur një aksident të rëndë

Detyra për nxënësit është të përcaktojnë prioritetet e të drejtave të njeriut të përfaqësuara nga thasët me zhavorr. Ata do të përdorin kritere të tilla si më poshtë. A ka një të drejtë në mënyrë implicite brenda një tjetrës? A ka një të drejtë me rëndësi të veçantë për demokracinë apo nevojat tona personale?
3. Sidoqoftë, baloni vazhdon të bie dhe më shumë thasë me zhavorr duhet të hedhin në intervale të rregullta kohore. Nxënësit duhet të hedhin më shumë thasë me zhavorr. Pasi të jenë hedhur katër ose pesë thasë, balona arrin në tokë në mënyrë të sigurt.

4. Reflektimi në rundin plenar. Secili grup paraqet listën e tij para gjithë klasës/grupit dhe shpjegon (disa nga) prioritetet e tyre. Pastaj listat mund të krahasohen. A ka shumë diferenca? Duhet të ketë edhe informim për punën në grupe. Ishte e vështirë të bie dakord? A ishte e vështirë t'u jepej prioritet disa të drejtave të njeriut ndërsa të tjerave jo? Shpresojmë se mund të bihet dakord që të gjitha të drejtat e njeriut të renditura janë të rëndësishme, por që njerëzit mund të ndryshojnë në prioritetet e tyre nëse do të duhej të zgjidhnin.

Në një Kushtetutë funksionuese, heqja e ndonjë prej këtyre të drejtave do të shkaktonte dëm serioz të demokracisë. Të drejtat e njeriut janë të drejta natyrore dhe për këtë arsye të patjetërsueshme. Udhëtimi me balonë ishte simulim i një situatë që shpresojmë të mos ndodhë kurrë - rregulli i një diktatori.

Nëse nxënësit vënë në dyshim rregullat e lojës mbi këto baza, atëherë objektivi i tij i mësimnxënies është arritur plotësisht.

Është e mundur të zgjerohet reflektimi duke shqyrtuar se cilat nga këto të drejta janë përfshirë në Kushtetutën e vendit dhe si mbrohen këto të drejta.

Materialet:

Zhavorri në balonë përbën të drejtat e mëposhtme:

zgjedhje të lira	liria e pronës	barazia e burrave dhe grave	një mjedis i pastër dhe i shëndetshëm	qasje në ushqim të shëndetshëm dhe ujë të pastër
e drejta e arsimit	liria e mendimit, ndërgjegjes/fesë	veshje dhe strehim për të gjithë qytetarët	jeta private pa ndërhyrje	liria e lëvizjes

Dëshirat dhe nevojat

Objektivat arsimore	Nxënësit kuptojnë diferencat midis gjërave që ata dëshirojnë ose do të dëshironin dhe çfarë u nevojitet vërtet.
Burimet	Letër, lapsa, gërsërë.

Procedura

1. Mësimdhënësi kërkon që nxënësit të vizatojnë disa nga gjërat që ata mendojnë se u duhen në copa letre (mësimdhënësi mund të përgatisë pjesët para orës mësimore ose të kërkojnë nga nxënësit t'i presin vetë). Ata mund të bëjnë rreth 8-10 vizatime secili.
2. Kur të jenë bërë vizatimet, mësimdhënësi i ndan nxënësit në grupe.
3. Secili grup atëherë duhet të bie dakord të heqë të gjitha vizatimet përveç pesë prej tyre. Vetëm pesë gjërat më të rëndësishme duhet të lihen në tryezë. Pastaj grupet i shpjegojnë njëri-tjetrit se çfarë kanë zgjedhur. A kanë zgjedhur të gjithë njësoj?

Zgjerimi

Mësimdhënësi var një tel (pe) rrobash nëpër klasë dhe vë disa vizatime në vijë. Ai diskuton me klasën se cilat vizatime mund të hiqen, gjëra për të cilat nuk u duhen vërtet. Në fund duhet të ketë vetëm pesë vizatime të varura në tel ose spango. A mund të bien dakord nxënësit për cilat pesë vizatime?

PERCEPTIMI I TË TJERËVE

Perceptimi i të tjerëve ashtu siç janë: Asnjë gjithëpërfshirje nuk mund të funksionojë pa këtë. Ne gjithashtu mund ta kuptojmë këtë si një term gjithnjë e më shumë të përdorur në mjediset shoqërore: ndjeshmëria. Ndjeshmëria i referohet aftësisë dhe gatishmërisë për të njohur, kuptuar dhe ndje me ndjesitë, emocionet, mendimet, motivet dhe tiparet e personalitetit të një personi tjetër. Një term i përgjithshëm gjuhësor që i përgjigjet kësaj është dhembshuria. Ndjeshmëria zakonisht llogaritet si aftësia për t'iu përgjigjur në mënyrë të përshtatshme ndjenjave të njerëzve të tjerë, për shembull keqardhje, trishtim, dhimbje dhe ndihmë nga dhembshuria. Sidoqoftë, hulumtimi i fundit i trurit sugjeron që aftësia e ndjeshmërisë është qartë e dallueshme nga dhembshuria. Baza e ndjeshmërisë është vetë-ndërgjegjësimi - sa më i hapur të jetë personi ndaj emocioneve të veta, aq më mirë është të interpretojë emocionet e të tjerëve.

Të gjithë të ndryshëm, të gjithë të barabartë

Objektivat arsimore	Nxënësit mësojnë të njohin dhe pranojnë njëri-tjetrin në një grup, pavarësisht nga ndryshimet e çfarëdo lloji. Nxënësit zbulojnë se çfarë kanë të përbashkët për të cilën nuk kishin dijeni. Nxënësit vetëdijesohen për qëndrimet dhe praktikatat që lidhen me diferencën.
Burimet	Një copë shkumësi ose një spango për të bërë një vijë në dysheme.

Procedura:

1. Mësimdhënësi bën thirrje për një varg karakteristikash një nga një. Sapo të përmendet, ata që pranojnë se kanë karakteristikën e kalojnë vijën.

Shembuj: të gjithë ata që ...

- ▶ janë veshur me xhinse
- ▶ kanë sy të kaltër
- ▶ janë më të vjetër
- ▶ kanë vizituar vende të tjera në Evropë
- ▶ rregullisht lexojnë gazetë
- ▶ i janë nënshtruar diskriminimit
- ▶ kanë miq homoseksualë
- ▶ kanë paragjykime, etj.

Nxënësve mund t'u kërkohet të sugjerojnë karakteristika, por mësimdhënësi duhet të jetë i vetëdijshëm se çfarë mund të jetë e ndjeshme.

2. Nxënësit diskutojnë çështjet vijuese:

- ▶ A e gjeti ndokush veten në një grup me dikë me të cilin kishin menduar se nuk kishin asgjë të përbashkët?
- ▶ Si ndihesh të jesh pjesë e një grupi të madh?
- ▶ Si ndihesh të jesh i vetëm?

Variacion

Sapo të përmendet një karakteristikë, nxënësit lëvizin në klasë për të formuar grupe të përbëra nga njerëz me të njëjtat karakteristika. Ata qëndrojnë së bashku për një moment në mënyrë që të diskutojnë se çfarë kanë të përbashkët. Ajo që thonë ata ka të bëjë me preferencat dhe sjelljen, për shembull.

E vërtetë dhe e rreme

Objektivat arsimore	<p>Nxënësit vetëdijesohen për stereotipet në mendjet e tyre dhe reflektojnë mbi to në mënyrë kritike.</p> <p>Ata e kuptojnë që thjeshtimet dhe stereotipet na ndihmojnë të përballemi me kompleksitetin e botës në të cilën jetojmë.</p> <p>Nxënësit zhvillojnë aftësitë e tyre për të bërë gjykime dhe për të marrë vendime. Duke vepruar kështu, ata inkurajohen të zhvillojnë një qëndrim kritik.</p>
Burimet	<p>Bankat dhe karriget duhet të largohen nga klasa. Një hapësirë “e vërtetë” dhe një “e rreme” përcaktohen në qoshet e kundërta të klasës.</p>

Procedura:

1. Nxënësit qëndrojnë në mes të klasës. Mësimdhënësi lexon një sërë deklaratash të vërteta ose të rreme për gratë, burrat, kombësi të ndryshme, etj.
Duke reaguar ndaj secilës deklaratë, nxënësit shkojnë në njërin cep ose në tjetrin në përputhje me atë që ata besojnë se është e vërtetë ose e rreme.
Nxënësit pa mendim qëndrojnë në mes.
2. Mësimdhënësi fton nxënësit të shpjegojnë zgjedhjet e tyre.
Mësimdhënësi jep përgjigjen e saktë. Është thelbësore që ky hap të mos mungojë kurrë.
3. Nxënësit i përgjigjen kontributit të mësimdhënësit. Mësimdhënësi i inkurajon ata të shpjegojnë se si i kanë perceptuar të tjerët, veçanërisht nëse këto perceptime janë dëshmuar të pasakta.

Zgjerimi

Nxënësit analizojnë mënyrën në të cilën mediat trajtojnë çështje që lidhen me pakicat, gjininë, dhunën, etj. Ata identifikojnë shembuj të stereotipave, paragjykimeve, sipërfaqësinë ose gazetarisë së përgjithshme dhe hulamtuese. Nxënësit përpiqen të korrigjojnë informacionin që ata besojnë se është i gabuar ose i paplotë.

Përshtypjet e para

Objektivat arsimore	Nxënësit janë në gjendje të identifikojnë stereotipet dhe të vetëdijesohen për llojllojshmërinë e përshtypjeve dhe perceptimeve që njerëzit kanë për njëri-tjetrin dhe praktikojnë dëgjim aktiv dhe mësojnë respekt për të tjerët.
Burimet	Fotografi të njerëzve të cilat mund të shkaktojnë reagime të ndryshme nga nxënësit janë vendosur në një fletë të madhe letre (mësimdhënësi duhet të zgjedhë personazhe shumë të ndryshme për sa i përket moshës, kulturës, grupit etnik, etj.).

Procedura:

1. Nxënësit formojnë një rreth. Mësimdhënësi i jep secilit nxënës një fletë letre.
2. Mësimdhënësi kërkon që secili nxënës të shikojë foton e tij/saj:
 - ▶ "Shoh ..."
 - ▶ "Mendoj ..."
 - ▶ "Ndiej ..."
3. Nxënësit shkruajnë përshtypjen e tyre të parë në fund të faqes. Ata palosin pjesën e poshtme të faqes në mënyrë që të fshehin tekstin dhe t'ia kalojnë fletën personit në të majtë.
3. Kjo vazhdon derisa të gjitha fletët të kenë kaluar shpejt rrethin.
4. Nxënësit krahasojnë përshtypjet e tyre të para:
 - ▶ Në çfarë mënyrash përshtypjet tuaja të para ishin të ndryshme ose të ngjashme?
 - ▶ Çfarë ju preku në përshtypjen tuaj të parë?
 - ▶ Cilat aspekte nuk i keni vërejtur dhe pse?
 - ▶ Çfarë ju tregoi aktiviteti për veten tuaj?

Zgjerimi

Ushtrimi mund të bëhet me një numër shumë të vogël fotografish, ose edhe vetëm me një foto ose video etnografike. Secilit nxënës gjithashtu mund t'i kërkohet të shkruajë përshtypjet e tij/saj në një copë letër.

Mësimdhënësi mund të japë informacion në lidhje me kulturat e tjera: ushqimin, muzikën, strukturën e familjes, etj.

Ne jemi të gjithë të barabartë, por disa janë më të barabartë se të tjerët

Objektivat arsimore	Nxënësit identifikojnë dhe analizojnë arsyet dhe motivet për diskriminimin ndaj të tjerëve. Ky ushtrim përqendrohet në atë se si faktorët socio-ekonomikë ndikojnë në shanset e suksesit shoqëror.
Burimet	Fletë të mëdha të trasha letre dhe lapsa markerësh.

Procedura:

1. Mësimdhënësi i ndan nxënësit në grupe jo më të mëdha se gjashtë veta. Grupet duhet të përbëhen nga një numër i barabartë nxënësish. Secili grup merr një fletë letre dhe një marker.
2. Ai/ajo kërkon nga gjysma e grupeve të vizatojnë një karikaturë të një fituesi shoqëror, gjysma tjetër një karikaturë të një humbësi.
3. Mësimdhënësi kërkon që grupet të rendisin karakteristikat e modelit të tyre: niveli socio-ekonomik, profesioni, gjinia, grupi etnik, aktivitetet e kohës së lirë, zgjedhja e veshjeve, pikëpamja themelore, mënyra e jetesës, lloji i banimit, zakonet e konsumimit.
4. Ai/ajo u kërkon grupeve të shkëmbejnë vizatimet e tyre dhe t'i interpretojnë ato.
5. Vizatimet varen në mur. Secilit grup i kërkohet të interpretojë vizatimin që ata kanë marrë për të gjithë klasën.
6. "Artistët" komentojnë mbi qëllimet e tyre. Duke komunikuar idetë prapa vizatimeve dhe efektin e vizatimeve tek shikuesi, nga nxënësit mund të pritet që të prekin pyetjet e mëposhtme:
 - ▶ Cilat janë karakteristikat kryesore të suksesit?
 - ▶ Cilat janë karakteristikat kryesore të dështimit?
 - ▶ Cilët janë faktorët që bëjnë diferencën midis "fituesve" dhe "humbësve"?
 - ▶ A përfaqësohen njerëzit nga grupe të caktuara?
 - ▶ A kanë të gjithë njerëzit të njëjtat shanse suksesi, pavarësisht prejardhjes së tyre shoqërore?

Zgjerimi

Cilat janë arsyet e diskriminimit, dhe përjashtimit, të njerëzve që janë të ndryshëm për shkak të kulturës, origjinës, sjelljes seksuale, gjuhës, etj.?

Cilat janë arsyet e pabarazisë midis njerëzve? A është barazia e mundur, dhe e dëshirueshme, apo jo?

PËRFSHIRJA NË PUNËN E PROJEKTIT - SHEMBUJ TË PROJEKTEVE MJEDISORE

HYRJE: EDUKIMI MJEDISOR ME HISTORI TË GJATË

Edukimi mjedisor ka histori të gjatë. Konferenca e parë botërore e UNESCO-s mbi edukimin mjedisor u mbajt në Tbilisi në vitin 1977. Prej ca kohë, edukimi mjedisor ka qenë gjithashtu një pjesë e integruar e kurrikulës. Që nga filltet e tij, edukimi mjedisor është zhvilluar vazhdimisht

- ▶ nga orientimi i problemit tek orientimi i burimeve
- ▶ nga një fokus në ndryshimet individuale të sjelljes në një përqendrim për shoqërinë në zgjidhjet e mundshme shoqërore për çështje të rëndësishme për mjedisin
- ▶ nga transferimi i diturisë së pastër në promovimin e kompetencave

Edukimi mjedisor është zhvilluar në një detyrë arsimore të ndërgjegjshme për ndërlíkueshmërinë dhe të orientuar drejt rrjetit. Cila është domethënia e edukimit mjedisor sot? Cilat janë qëllimet e tij? Çfarë kontributi në arsim për zhvillimin e qëndrueshëm?

Si mund të çojnë projektet e edukimit mjedisor në më shumë gjithëpërfshirje në shkolla?

Edukimi mjedisor nuk zhvillohet vetëm në shkollë. Edukimi mjedisor është një proces gjatë gjithë jetës për të mësuar nga parashkollori deri në moshën e vjetër. Edukimi mjedisor ndodh kudo në jetë. Përveç fushave tradicionale të sistemit të arsimit zyrtar (nga kopshti në universitet), edukimi mjedisor gjithashtu ndodh joformalisht dhe vetë-drejtuar në jetën e përditshme: gjatë diskutimeve në tryezën familjare për darkat e ditëlindjes (ushqim të shpejtë ose piknik), gjatë një shëtitje me miqtë në pyll, gjatë vullnetarizmit në një shoqatë (p.sh. organizatat e mbrojtjes së natyrës dhe mjedisit, organizatat për ruajtjen e natyrës, skautët), gjatë vizitave të vendeve jashtëkurrikulare të mësimit (parqet e natyrës, qendrat e ruajtjes së natyrës, muzetë, ekspozitat, etj.) gjatë punës vullnetare ose në vendin e punës.

Perspektiva arsimore: Edukimi mjedisor ka zhvillimin optimal të individit, të grupeve shoqërore dhe të shoqërive praktike dhe të harmonizuara përmes marrëdhënieve të tyre me mjedisin (natyror).

Edukimi mjedisor ndikon edhe në zhvillimin personal. Qëllimi është të promovohet një personalitet që është në gjendje të vlerësojë situatat dhe objektivat e problemit, të shqyrtojë vlerat e veta, të marrë vendime dhe të veprojë, dhe kështu të optimizojë rrjetin e marrëdhënieve midis individit, shoqërisë dhe mjedisit. Në këtë këndvështrim, edukimi mjedisor është gjithëpërfshirës duke kombinuar aspektet njohëse, afektive, sociale, etike dhe praktike.

Përmes aplikimit të qasjeve inovative pedagogjike edukimi mjedisor kontribuon në përmirësimin e proceseve të mësimdhënies dhe të mësimnxënies. Edukimi mjedisor synon të ofrojë një edukim që është më i përshtatur me realitetin e botës bashkëkohore dhe nevojat e shoqërisë së sotme.

Këtu ne propozojmë dy mënyra për të zbatuar disa nga qëllimet e edukimit mjedisor. Ndërsa kopshti i shkollës adreson një formë aktive dhe pozitive të aktivitetit, propozimi i dytë merret me reagimin ndaj pasojave negative të jetës njerëzore: male mbeturinash. Në të dy format, nxënësit bëhen aktivë dhe e përjetojnë veten e tyre si efektivë dhe aktivë. Ata gjithashtu e kuptojnë se kanë nevojë për njëri-tjetrin dhe të gjithë mund të kontribuojnë. Edukimi mjedisor do të thotë gjithëpërfshirje në veprim.

KOPSHT SHKOLLE: GËZIM DHE PUNË PËR TË GJITHË

Një kopsht shkollor u jep të gjithëve të përfshirë shumë kënaqësi dhe u mundëson mësimdhënësve dhe nxënësve të hedhin librat në qoshe për disa mësim dhe në vend të tyre të gërmojnë në tokë. Sidoqoftë, kopshti përfshin gjithashtu shumë detyra dhe obligime gjatë disa viteve. Prandaj, stafi arsimor duhet së pari të mendojë nëse shkolla ka kapacitet të mjaftueshëm për të mbajtur gjallë një kopsht shkollor.

Krijoni kushte për kopsht

Pyetja e parë e rëndësishme është nëse shkolla ka një tokë të përshtatshme për një kopsht shkollor të sapo mbjellë. Zona duhet të ofrojë të paktën hapësirë të mjaftueshme për një klasë shkollore për të punuar në të në grupe të vogla. Përveç kësaj, vendpunishtja duhet të jetë lehtësisht e qasshme për nxënësit me aftësi të kufizuara fizike dhe, në rastin më të mirë, të lihet hapësirë për zgjerim. Kopshti duhet të jetë sa më afër objektit të shkollës, por në të njëjtën kohë të mos jetë i dukshëm nga klasat. Përvoja ka treguar se një pikëpamje e tillë i tërheq vëmendjen nxënësve dhe e ngadalëson mësimdhënien.

Kërkimi për një zonë të përshtatshme zakonisht shkon shumë shpejt nëse drejtori, kujdestari dhe prindërit janë gjithashtu të përfshirë. Sidoqoftë, më e ndërlikuar është pyetja nëse një ose dy mësimdhënës janë të gatshëm të udhëheqin në planifikimin e kopshtit të shkollës. Meqenëse cikli i kopshtit nuk ndjek rrjedhën e një viti shkollor, duhet të sigurohet që në fazën e planifikimit dikush të kujdeset për kopshtin pas pushimeve verore.

Filloni me planifikimin e parë

Sapo të gjenden një ose dy mësimdhënës me njohuri për kopsht, organizimi mund të fillojë. Kjo varet kryesisht nga kush do të përfshihet më vonë në kopshtin e shkollës: A është menduar kryesisht për mësimdhënies në klasë apo ka një grup të veçantë kopshtarë në programin gjithë-ditor? Në varësi të kësaj, mësimdhënës të ndryshëm do të duhet të përfshihen. Por gjithashtu ka kuptim të përfshihen nxënësit që nga fillimi dhe t'i pyesni për dëshirat e tyre.

Si hap i parë, kopshtarët amatorë duhet të bëjnë një plan të shkallëzuar të kopshtit të ardhshëm. Kjo detyrë është një ushtrim i mirë për nxënësit, të cilët me siguri do të shijojnë mësimin në natyrë. Sidoqoftë, është e rëndësishme që ata gjithashtu të marrin parasysh diferencat në lartësinë e parcelës kur bëjnë matje dhe t'i kushtojnë vëmendje mbjelljes ekzistuese.

Mbi këtë bazë, mund të fillojë planifikimi konkret i projektit të kopshtit. Këtu një listë e shkurtër që mësimdhënësit mund të përdorin gjatë planifikimit të kopshtit:

Pikët e përmbledhura:

- ▶ Kush punon në kopshtin e shkollës? (Cila moshë, klasë, mësimdhënës, prindër etj.)
- ▶ Cili vend është i përshtatshëm? (A ka shkolla hapësirë të përshtatshme?)
- ▶ Cilat kultura në cilën formë janë planifikuar? (rrethojë, pemë, biotope ligatinore etj.)
- ▶ Cilat forma të shtratit janë planifikuar? (Shtretër tokësorë, shtretër me korniza, shtretër të ngritur në kuti etj.)
- ▶ Cilat lloje të kultivimit janë të mundshme (kultivimi i përzier, kultivimi në rresh, kultivimi i hershëm, etj.)?
- ▶ Çfarë infrastrukture është e nevojshme? (Ujë, kosha plehrash, vende pushimi etj.)
- ▶ Si duhet të përpunohet korrja? (Konsumi direkt, kuzhina shkollore, ruajtja)
- ▶ Cilat lëndë duhet të përfshihen? (Art, artizanat, orë mësimore pune etj.)
- ▶ Çfarë duam të arrijmë me kopshtin e shkollës? (Puna e projektit, kujdesi për pushimet, aktivitetet e pasdites, etj.)

Planifikimi konkret

Se si duket kopshti varet kryesisht nga nevojat e përdoruesve. Në parim, megjithatë, mësimdhënësit dhe nxënësit duhet të gjejnë një përzierje të ndjeshme të shtretërve me bimë zbukurose të dobishme dhe vendase, si dhe lëndina dhe shkurre. Për të siguruar që edhe këmbët e shkurtra të fëmijëve mund të arrijnë lehtësisht në shtretërit e kopshtit nga të gjitha anët, ato duhet të kenë një gjerësi maksimale prej 1-1.2 metra. Përreth shtretërve, duhet të krijohen rreshta me gjerësi rreth 70 centimetra ku karrocet mund të parkojnë rehat.

Kur zgjedhin bimë, mësimdhënësit duhet gjithashtu të gjejnë një përzierje të ndjeshme në mënyrë që kopshti të mos jetë tepër i përpunuar.

Kur i tërë planifikimi të ketë përfunduar më në fund, gjithçka që mungon janë mjetet e duhura. Rekomandohet pajisja themelore e mëposhtme:

- 1 Doreza pune
- 2 Karrocë dore
- 3 Kovë
- 4 Vaditëse
- 5 Gërshërë të mëdha kopshtesh
- 6 Shat dore (dhe lopatë)
- 7 Lopatë
- 8 Shat/grabujë
- 9 Pe dhe shkopinj për bimë
- 10 Lugë
- 11 Fshesë

Meqenëse duhet shumë kohë dhe përpjekje për të krijuar kopshtin e shkollës, duhet të gjenden vullnetarë në mesin e nxënësve dhe mësimitdhënësve, të cilët duhet të fillojnë kopshtin në fundjavë. Për kujdesin e mëtejshëm të kopshtit, duhet të hartohet një plan i qartë kujdesi në mënyrë që kopshti të shikohet në mënyrë optimale në çdo kohë.

Kopshtari mobile - nuk ka asnjë arsye për një 'jo'!

Meqenëse kopshti përfshin një përpjekje relativisht të lartë, shumë shkolla i shmangen asaj. Sidoqoftë, ata që as nuk duan të krijojnë një kopsht të ri shkollor dhe as nuk bëjnë pa përvojën e kopshtarisë, do të gjejnë një alternativë të mirë në kopshtarinë mobile. "Kopshtari në kuti" është një mënyrë në të cilën klasat shkollore mund të kultivojnë një kopsht mobil në një sipërfaqe prej disa metrash katrorë pa shumë përpjekje. Në shumë vende, janë krijuar shtretër të tillë të ngritur, të cilët janë shumë argëtues dhe gjithashtu mund të vendosen në zona me tarraca.

Por mund të jetë edhe më i vogël! Veçanërisht nxënësit e rinj janë të lumtur, për shembull, kur shohin bimë të vogla si rasati ose mashurka që rriten në pragun e dritares së klasës. Ky projekt i vogël është gjithashtu një hap i parë drejt mësimitdhënies së bazuar në natyrë, në të cilin janë të përfshirë të gjithë fëmijët.

MËSIMNXËNIA E BAZUAR NË SHËRBIM PËR NJË MJEDIS TË PASTËR: DITA E PASTRIMIT.

Hyrje: Qasja me nxënësin në qendër

Mësimnxënia e bazuar në shërbim është gjithashtu një mënyrë efektive për të zhvilluar gamën e plotë të KKD-së dhe në të njëjtën kohë të përfshijë të gjithë nxënësit që përdorin aftësitë e tyre si një potencial. Mësimnxënia e bazuar në shërbim u jep nxënësve mundësi për të lidhur njohuritë dhe të kuptuarit kritik dhe shkathësitë e marra në një mjedis klase me një veprim domethënës që synon një çështje të botës reale. Mësimnxënia e bazuar në shërbim është më shumë sesa shërbimi ndaj komunitetit. Kjo nënkupton ofrimin e një shërbimi ndaj komunitetit në kontekstin e një grupi të strukturuar hapash, në të cilin mësimitdhënësi luan një rol të rëndësishëm si organizator dhe lehtësues, duke mbajtur një qasje të fortë me nxënësit në qendër dhe duke i fuqizuar nxënësit të marrin vendime dhe të veprojnë sipas vullnetit të tyre në bashkëpunim me bashkëmohatarët.

Ndërsa mësimnxënia e bazuar në shërbim është një formë e të mësuarit të bazuar në projekte, një sekuencë e ngjashme e hapave do të shërbejë si referencë për procesin:

Vlerësimi i nevojave të komunitetit dhe identifikimi i përmirësimit ose ndryshimit që do të parashikohet;
Përgatitja e detyrës që do të ndërmerret duke mbledhur informacion, duke identifikuar dhe kontaktuar palët kryesore të interesit të komunitetit, duke analizuar opsionet për të adresuar çështjen dhe duke planifikuar ndërhyrjen;
Ndërmarrja e veprimeve duke u përfshirë në një aktivitet në shërbim të komunitetit i cili është domethënës për nxënësit dhe rrit mësimnxënien dhe zhvillimin e vlerave, qëndrimeve, shkathtësive dhe njohurive dhe të kuptuarit kritik. Veprimi mund të jetë i disa llojeve, duke përfshirë:
Prezantimin e punës dhe rezultateve përfundimtare të saj në komunitet dhe festimin e arritjeve;
Reflektimin mbi përvojën e mësimnxënies, mundësisht gjatë gjithë procesit, dhe vlerësimin e punës së bërë duke çuar në konkluzione dhe rekomandime për përmirësimin e efektivitetit të aktiviteteve të ngjashme në të ardhmen.

Mësimnxënia efektive e bazuar në shërbim ka disa karakteristika të cilat kontribuojnë në zhvillimin e gamës së plotë të vlerave, qëndrimeve, shkathtësive dhe njohurive dhe të kuptuarit kritik të përfshirë në modelin KKD:

- ▶ shkathtësitë e mendësisë qytetare por edhe të përgjegjësive, hapjes, ndjeshmërisë, vëzhgimit
- ▶ shkathtësitë e vetë-efikasitetit, e të menduarit analitik dhe kritik
- ▶ tolerancën e paqartësisë, shkathtësitë e mësimnxënies autonome dhe të menduarit kritik
- ▶ shkathtësitë e bashkëpunimit dhe zgjidhjeve të konflikteve, së bashku me fleksibilitetin dhe përshtatshmërinë, dhe shkathtësitë e komunikimit
- ▶ njohuritë dhe të kuptuarit kritik të botës
- ▶ hapja ndaj tjetërsisë kulturore, shkathtësitë e dëgjimit, shkathtësitë gjuhësore dhe të komunikimit
- ▶ reflektimi mbi vlerat, dhe njohuritë dhe të kuptuarit kritik të vetvetes

Mësimnxënia efektive e bazuar në shërbim: Planifikimi i një dite pastrimi hap pas hapi

Planifikimi i hershëm

Ideja themelore e një Dite Pastrimi është pastrimi i rajonit, fshatit, lagjes së bashku me sa më shumë klasa shkollore dhe kështu të vendosni një shembull të fortë dhe të qëndrueshëm kundër hedhjes së mbeturinave dhe për një mjedis të pastër. Për të siguruar që gjithçka të shkojë normalisht në ditën tuaj të veprimit dhe të mos ketë fatkeqësi, ka shumë për të menduar paraprakisht. Këto këshilla specifike duhet t'ju ndihmojnë të organizoni një ditë të suksesshme të pastrimit dhe çdo aktivitet shoqëruës.

Hartoni një koncept për ditën e veprimit tuaj anti-mbeturinë para se të filloni me planifikimin konkret. Për shembull, mendoni se kujt doni t'i drejtoheni me veprimet dhe çfarë qëllimesh dëshironi të arrini. Për ta bërë ditën tuaj të pastrimit edhe më tërheqëse, këshillohet gjithashtu të organizoni aktivitete shoqëruese të tilla si një shteg mbeturinash, një konkurs ose një festival me mbeturina të vogla.

b. Shkruaj një koncept letër

Një koncept letër ju ndihmon të mos e harroni qëllimin dhe të shmangni devijimet.

- ▶ Cilat synime duhet të arrihen?
- ▶ Cilat mesazhe duhet t'i komunikohen popullatës?
- ▶ Cilat grupe të synuara dëshironi të arrini?
- ▶ Cilat masa/veprime përdoren për të komunikuar me sukses mesazhet?
- ▶ A ka partnerë (shkolla, kompani, organizata ...) që mund të përfshihen?
- ▶ Cilat kanale dhe mjete komunikimi përdoren?
- ▶ A ka material të provuar që mund të përvetësohet?
- ▶ Si ta ndajmë fshatin, lagjen, rajonin në zona pastrimi? Cili grup apo cila klasë do të pastrojë (shih 'Lista e klasave të përfshira')? Po nxënësit me aftësi të kufizuara?

Formimi i një komiteti organizues. Kush bën çka?

Një komitet i fortë organizues (përfshirë nxënësit) ndihmon për të menduar gjithçka. Ai nuk duhet të jetë shumë i madh, por duhet të takohet rregullisht, të shkëmbejë informacion dhe të mbajë të informuar njëri-tjetrin. Ka kuptim të krijohen listat e detyrave për secilën fushë së bashku.

- ▶ Ekipi/koordinatori udhëheqës
- ▶ Reklamimi/media
- ▶ Infrastruktura
- ▶ Financat/sponsorët
- ▶ Koordinimi i grupeve pjesëmarrëse
- ▶ Veprimet koordinuese
- ▶ Siguria
- ▶ Administrimi (lejet/sigurimet/etj.)
- ▶ Vlerësimi

Lista e klasave të përfshira

Mos ndoshta jo të gjitha klasat janë të interesuara të marrin pjesë në këtë ditë? Mund të ndodhë që drejtorja e shkollës të vendosë se dita është e detyrueshme. Në këtë rast, do të jetë e rëndësishme të diskutohet vendimi me të gjithë mësimdhënësit dhe të sqarohet se si do të trajtohet rezistenca.

Mësimdhënësi; të dhënat e kontaktit	Mosha e nxënësve/klasa	Numri i nxënësve	Detyra e mundshme/ vendi i pastrimit/rrugët

Partnerë të mundshëm

Një ditë e tillë veprimi nuk duhet të bëhet kurrë e veçuar nga shkolla. Cilat organizata mund të bashkëpunojnë? Kush mund të jetë i interesuar të paraqitet për të pastruar së bashku me nxënësit? Ndoshta dikush do të financojë gjithashtu ushqimin ose materiale si doreza, thasë mbeturinash etj.?

- ▶ Djegia e mbeturinave
- ▶ Trajtimi i ujërave të ndotura
- ▶ Fabrika e riciklimit
- ▶ Deponia
- ▶ Klube sportive
- ▶ Klube muzikore
- ▶ Personalitete të mirënjohura

- ▶ Kompani
- ▶ Restorante

Siguria

Para fillimit të ngjarjes, informoni të gjithë pjesëmarrësit në lidhje me rregulloret e sigurisë. Sigurohuni që të gjithë pjesëmarrësit i kanë kuptuar udhëzimet e sigurisë dhe do të sillen në përputhje me rrethanat.

- ▶ Sqaroni numrat e telefonit të urgjencës
 - Zjarrfikësit:
 - Policia:
 - Mjeku:
 - Posta mjekësore
- ▶ Sqaroni sigurimin e pjesëmarrësve nga aksidentet
- ▶ Informoni nxënësit dhe kolegët paraprakisht në lidhje me veshjet dhe këpucët e përshtatshme (veshje të rehatshme, pantallona të gjata, këpucë të mbyllura, pajisje për mbrojtje nga era dhe moti).
- ▶ Mos zgjidhni vende dukshëm të rrezikshme.
- ▶ Shmangni rrugët e rrezikshme dhe shpatet e pjerrëta.
- ▶ Jini të vetëdijshëm për rreziqet natyrore.
- ▶ Nëse keni material me rrezik (shiringa, helme, kufoma kafshësh, etj.), të mblidhen vetëm nga profesionistë.
- ▶ Çdo grup i pastrimit i njëjti numrat e urgjencës dhe ka një telefon celular me vete.
- ▶ Siguroni pajisje të përshtatshme (doreza, darë për kapje, kova, thasë, etj.) dhe kontejnerë.
- ▶ Sigurohuni që materiali i mbledhur të hidhet në mënyrën e duhur (riciklimi, djegia e mbeturinave, mbeturinat e rrezikshme).
- ▶ Mos harroni të merrni pëlqimin e prindërve dhe t'i informoni ata në fazë të hershme

Reklamimi dhe media

Qasuni në mënyrë aktive mediave lokale dhe krijoni partneritete. Nxënësit duhet të marrin përsipër këtë punë dhe kështu të mësojnë gjithashtu si funksionon puna e mediave. Dizajnoni postera informativ me klasat e shkollës dhe shpërndajini ato në fshat/lagje.

- ▶ Cila media duhet të kontaktohet?
- ▶ A duhet të ketë ndonjë raportim paraprakisht?
- ▶ A do të vijë përfaqësuesit e mediave gjatë ditës së veprimit apo do të shkruajmë raporte vetë?
- ▶ Përdorni Facebook-un/mediat Sociale
- ▶ Organizoni intervista me pjesëmarrësit dhe udhëheqësit.
- ▶ Organizoni një turne me shtypin nga pika e mbledhjes në pikën tjetër të mbledhjes
- ▶ Komunikoni suksesin tuaj në faqen kryesore të shkollës, etj.
- ▶ Komuniteti në gazetatat lokale, në radion lokale, në TV lokale Dërgoni një

Financat

Vëzhgoni kostot në çdo kohë për të shmangur surpriza të pakëndshme. Sqaroni nëse kompanitë apo individët privatë janë të gatshëm të sponsorizojnë veprimin.

Mund të bëhen shpenzimet e mëposhtme:

- ▶ Materialet për mbledhjen e mbeturinave (shih listën më lart)
- ▶ Transporti i mbeturinave
- ▶ Sigurimet

- ▶ Ofrimi i ushqimit gjatë ditës
- ▶ Material reklamimi/informacioni (shih partnerët e mundshëm)

Vlerësimi

Vlerësoni me kujdes ditën e veprimit me të gjithë pjesëmarrësit. Kjo do të jetë një ngjarje e rëndësishme mësimore për nxënësit.


- ▶ Vlerësimi në klasat shkollore pjesëmarrëse
- ▶ Mbledhni informatat kthye nga i gjithë organizimi pjesëmarrës.
- ▶ Shkruani letra falënderimi.
- ▶ Mbledhni raporte mediatike.
- ▶ Ftojini komitetin organizues në një vakt
- ▶ Planifikoni përsëritjen
- ▶ Informoni autoritetet dhe prindërit për rezultatet

PJESA E:
LITERATURA

- ▶ Ainscow, M., Howes, A. dhe Tweddle, D. (2004). Dhënia e kuptimit të ndikimit të politikave arsimore të kohëve të fundit: studim i praktikës. Universiteti i Mançesterit: Instituti për Qeverisje Politike dhe Ekonomike.
- ▶ Austin, V. (2001). Bashkë-mësimdhënia dhe bindjet e mësimdhënësve. *Edukimi Ndihmës dhe Special*, 224, 245-255.
- ▶ Bauwens, J. & Hourcade, J. (1991). Bërja e bashkë-mësimdhënies strategji e integritit. *Parandalimi i dështimit të shkollave*, 35(4), 19-24.
- ▶ Bellamy, C. (n.d.). Gjendja e fëmijëve të botës: Arsimi. UNICEF.
- ▶ Brodessaer, E., Frohn, J., Welskop, N., Eckert, F., Liebsch, A.-C., Moser, V. & Pech, D. (Ed.), *Inklusionsorientierte Bausteine für die Hochschullehre*. Bad Heilbrunn: Klinkhardt.
- ▶ Carolyn C. Dumaresq, E. (n.d.). Referencë e tryezës së mësimdhënësve: Informacion praktik për mësimdhënësit e Pensilvanisë.
- ▶ Komonuelthi i Pensilvanisë.
- ▶ Korniza referencë e kompetencave për kulturë demokratike (KRKKD) e Këshillit të Evropës: <https://www.coe.int/en/web/reference-framework-of-competences-for-democrat-culture> (Qasur më 10 maj 2021)
- ▶ Eichholz, R. (2018): Eine Schule für Alle: Die inklusive Schule. Në: Rathmann, K./ Hurrelmann, K. (Hg.): *Leistung und Wohlbefinden in der Schule: Herausforderung Inklusion*. Weinheim, S. 368 – 382.
- ▶ Agjencia Evropiane për Zhvillim në Arsimin për Nevoja të Veçanta. <https://www.european-agency.org/resources/publications/TPL4I-final-summary-report>
- ▶ Bashkimi Evropian. Arsimi gjithëpërfshirës. Ndërtimi i shoqërive gjithëpërfshirëse dhe kohezive përmes arsimit. https://ec.europa.eu/education/policies/european-policy-cooperation/inclusive-education_en
- ▶ Fullan, M. (1991). Kuptimi i ri i ndryshimit arsimor. Cassell.
- ▶ Keefe, E., Moore, V., & Duff, F. (2004). Të katër "dinë" për mësimdhënie bashkëpunuese. *Mësimdhënia e fëmijëve të jashtëzakonshëm*, 36(5), 36-42
- ▶ Hollenweger, J. (2018). Zbatimi i KNF-së në arsim dhe kujdes. Në S. Castro & O. Palikara (Ed.). *Një qasje në zhvillim e arsimit dhe kujdesit. Zbatimi i një klasifikimi botëror të funksionimit dhe aftësisë së kufizuar*. Nju Jork: Routledge, 33-51.
- ▶ Hollenweger, J. (2018). Gemeinsam Lerngelegenheiten schaffen, statt hier unterrichten und dort fördern. *Schweizerische Zeitschrift für Heilpädagogik*, 24, S. 22-29.
- ▶ Imhäuser, K. (2016): Bildung für nachhaltige Entwicklung und Implementierungsmechanismen in der schulischen Infrastruktur. <https://schulen-planen-und-bauen.de/2016/12/08/bildung-fuer-nachhaltige-entwicklung/> (Qasur më 17 maj 2021)
- ▶ Lawton, M. (1999). Bashkë-mësimdhënia - A janë dy koka më të mira sesa një në një klasë gjithëpërfshirëse? Harvard
- ▶ Letër arsimore, mars/prill, 1-4.
- ▶ Leatherman, J. & Niemeyer, J. (2005). Qëndrimet e mësimdhënësve ndaj gjithëpërfshirjes: faktorët që ndikojnë praktikën në klasë.
- ▶ Revistë e edukimit të mësimdhënësve në fëmijëri të hershme, 26, 23-36.
- ▶ Lingard, B. & Mills, M. (2007). Pedagogjitë që bëjnë diferencë: çështjet e drejtësisë sociale dhe gjithëpërfshirjes.
- ▶ Revista ndërkombëtare e arsimit gjithëpërfshirës, 11 (3), 233-244.
- ▶ OSBE - PASQYRË E KOMUNITETEVE ROMË, ASHKALINJË DHE EGJIPTIANË NË KOSOVËS. https://www.osce.org/files/f/documents/6/7/443587_1.pdf (Qasur më 22 maj 2021)
- ▶ Ndërhyrjet dhe mbështetjet pozitive të sjelljes. Marrë nga <https://www.pbis.org/school> (Qasur më 27 prill 2021)
- ▶ UNICEF: Arsimi gjithëpërfshirës. Përfshirja e fëmijëve me aftësi të kufizuara në të mësuarit cilësor: çfarë duhet bërë? https://www.unicef.org/eca/sites/unicef.org.eca/files/IE_summary_accessible_220917_brief.pdf (Qasur më 23 prill 2021)
- ▶ Uebfaqja e burimeve të World of Inclusion Ltd. <http://worldofinclusion.com/resources/> (Qasur më 17 prill 2021)
- ▶ Wood, J. (2009). *Strategji praktike për klasën gjithëpërfshirëse*. Nju Xhersi: Pearson.

COMPETENCES FOR DEMOCRATIC CULTURE

20 Competences for Democratic Culture and their matching 135 Descriptors to help you detect the strength and weakness of the democratic culture in schools and elsewhere.



Posteri i kopshtit i KRKKD-së

Më shumë informata
www.coe.int/education

Kontakti

Zyra e Këshillit të Evropës
17/18 Rruga Bedri Pejani
10000 Prishtinë

Email:

coe.pristina@coe.int
education.pristina@coe.int

Tel: 383 (0) 38 407 750

Faksi: +383 (0) 38 407 751

Këshilli i Evropës është organizata kryesore e kontinentit për të drejtat e njeriut. Në të bëjnë pjesë 47 shtete anëtare, duke përfshirë të gjitha shtetet anëtare të Bashkimit Evropian. Të gjithë shtetet anëtare të Këshillit të Evropës kanë nënshkruar Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dokument i cili është hartuar për të mbrojtur të drejtat e njeriut, demokracinë dhe shtetin e së drejtës. Gjykata Evropiane mbikëqyr zbatimin e Konventës nga shtetet anëtare.

www.coe.int

Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian kanë vendosur të lidhin së bashku dijen, burimet dhe fatet e tyre. Së bashku, ata kanë ndërtuar një zonë të stabilitetit, demokracisë dhe zhvillimit të qëndrueshëm, duke e ruajtur kulturën diversitetit, tolerancën dhe liritë individuale. Bashkimi Evropian është i angazhuar t'i ndajë arritet dhe vlerat e tij me vendet dhe popujt përtej kufijve të saj.

<http://europa.eu>

Funded
by the European Union
and the Council of Europe



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Implemented
by the Council of Europe